



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Prot. nr. 1947
dt 04.11.2019

VENDIM

Nr. 12 Datë 11.11.2019


Për miratimin e Manualit Udhëzues për certifikimin e AME-ve dhe certifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

Në mbështetje të nenit 13, pika g, të Ligjit Nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për
Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 262, datë
28.06.2019, “ Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat
administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil ”,

VENDOSA:

1. Miratimin e Manualit Udhëzues për certifikimin e AME-ve dhe certifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror- O3-3.MU/PT.001 së bashku me format
e tij bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Liçencimit dhe Mbikqyrjes së Personelit Ajror në
DMSOVA për zbatimin e këtij Manuali Udhëzues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Krislen Keri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë



MANUAL UDHËZUES

Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

TETOR 2019

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Hyrje

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil të Shqipërisë

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij manuali ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të AAC-së dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjësin përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.

Për Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar

Krislen Keri,
Drejtor Ekzekutiv

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

PARATHËNIE

Ky manual udhëzues është hartuar bazuar në ligjin Nr.10040 datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit Nr. 262 datë 28.06.2019, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, Pjesa-Mjekësore, si dhe mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (AMC) të EASA-s.

Manuali ka për qëllim të informojë aplikantët dhe ekzaminuesit aero-mjekësorë (AME) për kërkesat, procedurat dhe detyrimet në lidhje me çertifikimin e AME-ve, si dhe kryerjen e ekzaminimeve aero-mjekësore dhe vlerësimin e përshtatshmërisë mjekësore të ekuipazhit ajror.

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

LISTA E FAQEVE EKZISTUESE

Pjesa	Faqe	Rishikimi	Datë		Pjesa	Faqe	Rishikimi	Datë
<u>1</u>	<u>11</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>6</u>	<u>37</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>12</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>6</u>	<u>38</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>13</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>6</u>	<u>39</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>14</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>6</u>	<u>40</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>15</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>6</u>	<u>41</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>16</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7</u>	<u>42</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>2</u>	<u>17</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>43</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>3</u>	<u>18</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>44</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>4</u>	<u>19</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>45</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>19</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>46</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>20</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>47</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>21</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>48</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>22</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>49</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>23</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>50</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>24</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>51</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>25</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>52</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>26</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>53</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>27</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>54</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>28</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>55</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>29</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>56</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>30</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>57</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>31</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>58</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>32</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>59</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>33</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>60</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>34</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>61</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>35</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>62</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>
<u>5</u>	<u>36</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>		<u>7.1</u>	<u>63</u>	<u>00</u>	<u>24.10.19</u>

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 4 nga 158
-----------------------------	------------------	-----------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror		
	Zotëruesi		AAC
	Dokumenti		O3-3.MU/PT.001

7.1	64	00	24.10.19		7.1	100	00	24.10.19
7.1	65	00	24.10.19		7.1	101	00	24.10.19
7.1	66	00	24.10.19		7.1	102	00	24.10.19
7.1	67	00	24.10.19		7.1	103	00	24.10.19
7.1	68	00	24.10.19		7.1	104	00	24.10.19
7.1	69	00	24.10.19		7.1	105	00	24.10.19
7.1	70	00	24.10.19		7.1	106	00	24.10.19
7.1	71	00	24.10.19		7.1	107	00	24.10.19
7.1	72	00	24.10.19		7.1	108	00	24.10.19
7.1	73	00	24.10.19		7.1	109	00	24.10.19
7.1	74	00	24.10.19		7.1	110	00	24.10.19
7.1	75	00	24.10.19		7.1	111	00	24.10.19
7.1	76	00	24.10.19		7.1	112	00	24.10.19
7.1	77	00	24.10.19		7.1	113	00	24.10.19
7.1	78	00	24.10.19		7.1	114	00	24.10.19
7.1	79	00	24.10.19		7.1	115	00	24.10.19
7.1	80	00	24.10.19		7.1	116	00	24.10.19
7.1	81	00	24.10.19		7.2	117	00	24.10.19
7.1	82	00	24.10.19		7.2	118	00	24.10.19
7.1	83	00	24.10.19		7.2	119	00	24.10.19
7.1	84	00	24.10.19		7.2	120	00	24.10.19
7.1	85	00	24.10.19		7.2	121	00	24.10.19
7.1	86	00	24.10.19		7.2	122	00	24.10.19
7.1	87	00	24.10.19		7.2	123	00	24.10.19
7.1	88	00	24.10.19		7.2	124	00	24.10.19
7.1	89	00	24.10.19		7.2	125	00	24.10.19
7.1	90	00	24.10.19		7.2	126	00	24.10.19
7.1	91	00	24.10.19		7.2	127	00	24.10.19
7.1	92	00	24.10.19		7.2	128	00	24.10.19
7.1	93	00	24.10.19		7.2	129	00	24.10.19
7.1	94	00	24.10.19		7.2	130	00	24.10.19
7.1	95	00	24.10.19		7.2	131	00	24.10.19
7.1	96	00	24.10.19		7.2	132	00	24.10.19
7.1	97	00	24.10.19		7.2	133	00	24.10.19

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror		
	Zotëruesi		AAC
	Dokumenti		O3-3.MU/PT.001

7.2	134	00	24.10.19		7.3	154	00	24.10.19
7.2	135	00	24.10.19		7.4	155	00	24.10.19
7.3	136	00	24.10.19		7.4	156	00	24.10.19
7.3	137	00	24.10.19		7.4	157	00	24.10.19
7.3	138	00	24.10.19		7.4	158	00	24.10.19
7.3	139	00	24.10.19		7.4	159	00	24.10.19
7.3	140	00	24.10.19					
7.3	141	00	24.10.19					
7.3	142	00	24.10.19					
7.3	143	00	24.10.19					
7.3	144	00	24.10.19					
7.3	145	00	24.10.19					
7.3	146	00	24.10.19					
7.3	147	00	24.10.19					
7.3	148	00	24.10.19					
7.3	149	00	24.10.19					
7.3	150	00	24.10.19					
7.3	151	00	24.10.19					
7.3	152	00	24.10.19					
7.3	153	00	24.10.19					

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

PËRKUFIZIME

Për qëllimin e këtij manuali, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

"Konkluzion mjekësor i akredituar" nënkupton konkluzionin e një ose më shumë ekspertëve mjekësorë tek organi kompetent liçencues, i bërë në bazë të kriterëve objektive dhe jodiskriminuese për qëllimet e rastit të shqyrtuar, në konsultim me ekspertë të operimeve të fluturimit ose ekspertë të tjerë sipas rastit.

"Vlerësim" nënkupton një përfundim mbi aftësinë mjekësore të një personi bazuar në një vlerësim të historisë mjekësore personale dhe / ose ekzaminimeve aero-mjekësore siç kërkohet në këtë seksion, si dhe ekzaminimet e mëtejshme, nëse është e nevojshme, dhe / ose ekzaminime mjekësore siç janë, por jo të kufizuar në, EKG, matjen e presionit të gjakut, testin e gjakut, rregjistrimin me rreze x.

"Siguri në ngjyra" do të thotë aftësia e aplikuesit për të dalluar lehtësisht ngjyrat e përdorura në navigacionin aeronautik dhe për të identifikuar me saktësi ngjyrat e ndriçimeve në aviacion.

"Specialist i shikimit" nënkupton një oftalmolog ose një specialist i shikimit i kualifikuar në optometri dhe i kualifikuar për të njohur kushtet patologjike.

"Ekzaminim" do të thotë inspektim, palpim, perkusion dhe auskultim ose mënyra të tjera shqyrtuese specifike për diagnostikimin e sëmundjes.

"Hetim" nënkupton vlerësimin e gjendjes patologjike të dyshuar të aplikantit përmes një ekzaminimi dhe me qëllim të konfirmimit të pranisë ose përjashtimit të një gjëndjeje shëndetësore.

"Autoriteti liçencues" nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar që ka lëshuar liçencën, ose tek i cili një person aplikon për lëshimin e një liçence, ose, kur një person nuk ka aplikuar ende për lëshimin e një liçence, në përputhje me këtë Pjesë.

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 7 nga 158
-----------------------------	------------------	-----------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

'Kufizimi' nënkupton një kusht të vendosur në çertifikatën mjekësore, në liçencë, ose në raportin mjekësor të ekuipazhit të kabinës, i cili duhet të respektohet ndërkohë që ushtrohen privilegjet e liçencës, (Dëshmisë).

“Gabime Përthyesë (refraktive)” nënkupton shmangien nga emetropia, e matur në dioptrë në meridianin më ametropik dhe me metodat standarde.

SHKURTIME

Në këtë manual do të përdoren shkurtime të mëposhtme, të cilat do të nënkuptojnë:

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë
EASA	Agjencia Europiane e Sigurisë së Aviacionit
BE	Bashkimi Europian
RSH	Republika e Shqipërisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
DE	Drejtor Ekzekutiv
AME	Ekzaminues Aeromjekësor
AeMC	Qendër Aeromjekësore
DMSOVA	Drejtorja e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Operim dhe Vlefshmërisë Ajrore
GMP	Mjekët e përgjithshëm
OHMP	Mjekët e përgjithshëm të punës
ZPAE	Zona e Përbashkët Ajrore Europiane
MED	Mjekësore

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje.....	2
Parathënia	3
Lista e Faqeve Efektive dhe Tabela e aprovimit	4
Lista e Shpërndarjes.....	7
Tabela e rishikimeve.....	7
Termet dhe Përkufizimet / Shkurtime/ Shpjegimi i Simboleve	8
1. Qëllimi i dokumentit	11
2. Ekzaminuesi Aero-Mjekësor (AME)	11
3. Dispozitat e zbatueshme/ Udhëzimet.....	18
4. FORMAT	19
5. Çertifikimi Aero-Mjekësor	19
6.Rënia e aftësisë shëndetësore.....	37
7.Anekset	42
7.1.Aneksi I : Kërkesat mjekësore, ekzaminimet dhe vlerësimet - KLASA 1/ KLASA 2	43
7.2 Aneksi II: Kërkesat mjekësore, ekzaminimet dhe vlerësimet LAPL.....	117
7.3 Aneksi III: Kërkesat mjekësore, ekzaminimet dhe vlerësimet për ekuipazhin e kabinës.....	136
7.4 Aneksi IV: Mjekimi - Udhëzues për pilotët dhe ekuipazhin e kabinës	155

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 9 nga 158
-----------------------------	------------------	-----------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Qëllimi i dokumentit

Ky manual udhëzues ka për qëllim të informojë aplikantët dhe ekzaminuesit aero-mjekësorë (AME) për kërkesat, procedurat dhe detyrimet në lidhje me çertifikimin AME-ve, si dhe kryerjen e ekzaminimeve mjekësore dhe vlerësimin e përshtatshmërisë mjekësore të ekuipazhit ajror.

2. Ekzaminuesi Aero-Mjekësor (AME)

2.1 Çertifikata e Ekzaminuesit Aero-Mjekësor

2.1.1 Privilegjet

AME mund të çertifikohet sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 262 datë 28.06.2019, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, i cili transpozon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011, e ndryshuar, për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të ekuipazhit ajror të avionëve.

(a) Privilegjet e AME-ve të çertifikuara sipas rregullores së mësipërme janë ato për lëshimin, rivalidimin dhe rinovimin e një çertifikate të kategorive mjekësore klasa 2 dhe çertifikatën mjekësore LAPL, kryerjen e vlerësimeve dhe ekzaminimeve përkatëse mjekësore.

(b) Mbajtësit e një çertifikate AME mund të aplikojnë për shtrirjen e privilegjeve të tyre, duke përfshirë ekzaminimet mjekësore për rivalidimin dhe rinovimin e çertifikatave mjekësore të klasës 1, nëse ato përputhen me kërkesat e përcaktuara në pikën MED.D.015.

(c) Privilegjet e mbajtësit të një çertifikate AME të përmendur në pikat (a) dhe (b) duhet të përfshijnë privilegjet për kryerjen e kontroleve dhe vlerësimeve aero-mjekësore të anëtarëve të ekuipazhit të kabinës dhe për sigurimin e raporteve mjekësore të anëtarëve të ekuipazhit të kabinës, sipas rastit, në përputhje me Pjesën-MED.

(d) Objekti i privilegjeve të mbajtësit të një çertifikate AME, dhe çdo kusht i saj, do të specifikohet në atë çertifikatë.

(e) Mbajtësi i një çertifikate AME nuk duhet të mbajë në asnjë rast më shumë se një çertifikatë AME të lëshuar në përputhje me këtë rregullore.

(f) Mbajtësit e një çertifikate AME nuk duhet t'i kryejnë ekzaminimet dhe vlerësimet aero-mjekësore në një Shtet Anëtar të ZPAE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, kur AAC ka lëshuar çertifikatën e tyre AME, përveç në rastin kur ata kanë përmbyshur të gjitha hapat e mëposhtëm:

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 10 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

- (1) u është dhënë akses nga shtet tjetër anëtar i ZPAE-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe për ushtrimin e aktiviteteve të tyre profesionale si mjekë të specializuar;
- (2) kanë njoftuar autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Anëtar të ZPAE-së për synimin e tyre për të kryer ekzaminime dhe vlerësime aero-mjekësore dhe për të lëshuar çertifikata mjekësore brenda objektit të privilegjeve të tyre si AME;
- (3) kanë marrë një njoftim nga autoriteti kompetent i atij Shteti tjetër Anëtar të ZPAE-së.

2.1.2 Aplikimi

Aplikimi për çertifikimin AME duhet të dorëzohet në formën dhe mënyrën e përcaktuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil (O3-3.FMU/PT.001.FRM.003) Aplikantët për çertifikatën AME duhet të dorëzojnë tek Autoriteti i Aviacionit Civil:

1. Detajet personale dhe adresën profesionale;
 2. Dokumentacionin që demonstroi se ata janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në MED.D.10, duke përfshirë çertifikatat e përfundimit të kursit të mjekësisë së aviacionit për privilegjet e duhura për të cilat bëhet aplikimi,
 3. Një deklaratë me shkrim që, sapo të jetë lëshuar çertifikata AME, AME do të lëshojë çertifikata mjekësore në bazë të kërkesave të kësaj rregulloreje.
- Kur AME-të kryejnë ekzaminime aero-mjekësore në më shumë se një vend, ata i japin autoritetit kompetent informacione përkatëse në lidhje me të gjitha vendodhjet e praktikës dhe facilitetet e praktikës.

Aplikantët për çertifikatën AME me privilegjin e lëshimit fillestar, rivleftësimit dhe rinovimit të çertifikatave të përshtatshmërisë mjekësore të klasës 2, LAPL, dhe raportin mjekësor të anëtarëve të ekuipazhit të kabinës duhet të:

- (a) Jenë plotësisht të kualifikuar dhe të kenë liçencat e duhura për ushtrimin e mjekësisë dhe të kenë dëshmi për përfundimin e trajnimeve mjekësore të specializuara (të jenë mjekë specialistë);
- (b) Të kryejnë një kurs bazë në mjekësinë e aviacionit;
- (c) Të vërtetojnë/dëshmojnë tek autoriteti kompetent që:

1. Kanë pajisje adekuate, procedura, dokumentacion dhe pajisje funksionale të përshtatshme për ekzaminime aero-mjekësore ; dhe

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 11 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

2. Kanë procedura dhe kushte të nevojshme për të siguruar konfidencialitetin mjekësor.

Aplikantët për zgjerimin e privilegjeve të çertifikatës AME për rivleftësimin dhe rinovimin e çertifikatave të përshtatshmërisë mjekësore të Klasit 1, duhet të kenë një çertifikatë të vlefshme AME dhe të kenë:

- (a) kryer të paktën 30 ekzaminime për lëshimin, rivalidimin ose rinovimin e çertifikatave mjekësore të klasës 2 ose çertifikatave ekuivalente për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet para aplikimit;
- (b) përfunduar me sukses një kurs trajnimi të avancuar në mjekësinë e aviacionit, duke përfshirë trajnimin praktik në metodat e ekzaminimit dhe vlerësimet aero-mjekësore;
- (c) përfunduar me sukses trajnimin praktik me kohëzgjatje prej të paktën 2 ditë, ose me një AeMC ose nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.

2.1.3. Ndryshimet në çertifikatën AME

AME-të duhet të njoftojnë autoritetin kompetent për ndryshimet e mëposhtme që mund të ndikojnë në çertifikatën e tyre:

1. AME i është nënshtruar procedurave ose hetimeve disiplinore nga një organ rregullator mjekësor;
2. Ka ndryshime në kushtet në të cilat është marrë një çertifikatë, duke përfshirë edhe përmbajtjen e deklaratës së dorëzuar në kërkesë;
3. Nuk i plotëson më kërkesat për lëshim;
4. Ekzaminuesi aero-mjekësor ndryshon vendndodhjen e praktikës ose adresën e korrespondencës. Dështimi për të njoftuar autoritetin kompetent do të rezultojë në pezullimin ose heqjen e privilegjeve të çertifikatës, bazuar në vendimin e autoritetit kompetent që pezullon ose revokon çertifikatën.
5. Nëse autoritetet kompetente nuk njoftohen për sa më sipër, kjo mund të shkaktojë pezullimin ose revokimin e çertifikatës AME në përputhje me pikën ARA.MED.250 të Pjesës ARA).

2.1.4. Periudha e vlefshmërisë së çertifikatave AME

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 12 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Çertifikata AME duhet të lëshohet për një periudhë që nuk i kalon 3 vjet, përveç nëse AAC-ja vendos t'a reduktojë këtë periudhë për arsye të justifikuara që lidhen me rastin individual.

(a) Rivalidimi

Me kërkesën e mbajtësit, çertifikata do të rivalidohet, në përputhje me Urdhrin e Ministrit Nr.262, datë 28.06.2019 që transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 (Rregullorja e Ekuipazhit Ajror), e ndryshuar kur mbajtësi i çertifikatës AME:

- (1) të vazhdojë të përmbushë kushtet e përgjithshme të kërkuara për praktikën mjekësore dhe të mbajë liçencën e tij/saj për ushtrimin e mjekësisë;
- (2) ka marrë pjesë në trajnime për rifreskimin e mjekësisë së aviacionit brenda 3 viteve të fundit;
- (3) ka kryer të paktën 10 ekzaminime aero-mjekësore ose të barazvlefshme me to çdo vit;
- (4) mbetet në përputhje me kushtet e çertifikatës;
- (5) ushtron privilegjet në përputhje me kërkesat e këtij Aneksi (Pjesa-MED);
- (6) ka provuar se ai ose ajo gëzon kompetenca aero-mjekësore në përputhje me procedurën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

(b) Rinovimi

Me kërkesën e mbajtësit, çertifikata do të rinovohet, në përputhje me Urdhrin e Ministrit nr.262, datë 28.06.2019 që transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 (Rregullorja e Ekuipazhit Ajror), e ndryshuar kur mbajtësi i çertifikatës AME të jetë në përputhje me kërkesat për rivalidim të përcaktuara në pikën (a) ose me të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- (1) të vazhdojë të përmbushë kushtet e përgjithshme të kërkuara për praktikën mjekësore dhe të mbajë liçencën e tij/saj për ushtrimin e mjekësisë;
- (2) ka marrë pjesë në trajnime për rifreskimin e mjekësisë së aviacionit brenda vitit të fundit;
- (3) ka përfunduar me sukses trajnimet praktike brenda vitit të fundit, ose në një AeMC ose nën mbikëqyrjen e autoritetit kompetent.
- (4) mbetet në përputhje me kërkesat e pikës MED.D.010;
- (5) ka provuar/vërtetuar se ai ose ajo gëzon kompetenca aero-mjekësore në përputhje me procedurën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

2.2 DETYRIMET E AME-së

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 13 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

2.2.1. Konfidencialiteti Mjekësor

Të gjithë personat e përfshirë në ekzaminimet mjekësore duhet të sigurojnë respektimin e konfidencialitetit mjekësor në çdo rast.

Të gjithë bashkëpunëtorët AME duhet të nënshkruajnë një Deklaratë të Konfidencialitetit.

Për qëllime të vlerësimit dhe standardizimit aero- mjekësor, rekordet aero -mjekësore duhet t'i vihen në dispozicion vetëm pas pëlqimit të aplikantit / mbajtësit të liçencës:

1. AeMC, AME ose GMP-ve për përfundimin e vlerësimit aero mjekësor;
2. Një komiteti të auditimit mjekësor që mund të krijohet nga autoriteti kompetent për auditimin e shkallës së dytë për rastet e kufitare;
3. Një vlerësuesi mjekësor të autoritetit kompetent të AAC-së me qëllim të mbikëqyrjes së përbashkët;
4. Aplikantit / mbajtësit të liçencës me kërkesë të tij me shkrim;dhe
5. Pas zbulimit të identitetit të aplikantit / mbajtësit të liçencës sipas Pjesës-FCL për qëllim të standartizimit.

2.2.2. Kryerja e ekzaminimeve dhe / ose vlerësimeve mjekësore

Gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjekësore dhe / ose vlerësimeve, AME duhet të:

- (a) sigurohen që komunikimi me aplikantin të ndodhi pa pengesa gjuhësore;
- (b) vënë në dijeni aplikantin për pasojat e dhënies së deklaratave të paplota, të pasakta ose të rreme për historikun e tyre mjekësor;
- (c) njoftojnë autoritetin liçencues ose, në rastin e mbajtësve të vërtetimeve të ekuipazhit të kabinës, njoftojnë autoritetin kompetent nëse aplikanti jep deklarata të paplota, të pasakta ose të rreme për historikun e tij mjekësor;
- (d) njoftojnë autoritetin liçencues nëse një aplikant tërheq aplikimin për një çertifikatë mjekësore në çdo fazë të procesit.

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Pas përfundimit të ekzaminimeve dhe vlerësimeve aero-mjekësore, AeMC, AME, GMP dhe OHMP-të do të:

(a) njoftojnë aplikantin nëse ai ose ajo është ose jo i papërshtashëm, ose do t'i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçencues, AeMC-së ose AME-së, sipas rastit;

(b) njoftojnë aplikantin për çdo kufizim që mund të kufizojë trajnimin e fluturimit ose privilegjet e liçencës së tij ose të saj ose vërtetimit të ekuipazhit të kabinës, sipas rastit;

(c) nëse aplikanti është vlerësuar si i paaftë, e njoftojnë atë për të drejtën e tij ose të saj për të shqyrtuar vendimin në përputhje me procedurat e autoritetit kompetent;

(d) në rastin e aplikantëve për një çertifikatë mjekësore, dorëzojnë pa vonesë tek vlerësuesi mjekësor i autoritetit liçencues një raport të nënshkruar ose të çertifikuar në mënyrë elektronike, që përmban rezultatet e hollësishme të ekzaminimeve dhe vlerësimeve aero-mjekësore siç kërkohet për klasën e çertifikatës mjekësore, si dhe një kopje të formularit të aplikimit, formularin e ekzaminimit dhe çertifikatën mjekësore;

(e) njoftojnë aplikantin për përgjegjësitë e tij ose të saj në rast të përkeqësimit të përshtatshmërisë mjekësore, siç përcaktohet në pikën MED.A.020.

(f) Kur kërkohet konsultimi me vlerësuesin mjekësor të autoritetit liçencues në përputhje me Pjesën MED), AeMC dhe AME duhet të ndjekin procedurën e përcaktuar nga autoriteti kompetent.

(g) AeMC-të, AME-të, GMP-të dhe OHMP-të duhet të mbajnë të dhëna të detajuara të ekzaminimeve dhe vlerësimeve aero-mjekësore të kryera në përputhje me Pjesën-MED dhe rezultatet e tyre për një periudhë të paktën prej 10 vitesh ose për një periudhë më të gjatë nëse përcaktohet kështu nga legjislacioni kombëtar.

(h) AeMC-të, AME-të, GMP-të dhe OHMP-të dorëzojnë tek vlerësuesi mjekësor i autoritetit kompetent, sipas kërkesës, të gjitha të dhënat dhe raportet aero-mjekësore, si dhe çdo informacion tjetër përkatës, kur kërkohet për:

(1) çertifikim mjekësor;

(2) funksionet e mbikëqyrjes.

(AeMC-të dhe AME-të regjistrojnë ose përditësojnë të dhënat e përfshira në Bazën e të Dhënave Aero-Mjekësore)

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

2.2.3. Të dhënat e ekzaminimeve të kryera mjekësore, çertifikatat e përshtatshmërisë mjekësore dhe ruajtja e dokumentacionit mjekësor

AME-të duhet të mbajnë rekorde të detajeve të ekzaminimeve dhe vlerësimeve mjekësore, si dhe rezultatet e tyre, në përputhje me legjislacionin kombëtar. Kur kërkohet për çertifikim mjekësor dhe / ose funksione mbikëqyrëse, AME duhet të dorëzojë të gjitha dokumentat dhe raportet aero-mjekësore, si dhe çdo informacion tjetër përkatës, në bazë të kërkesës së mjekut përkatës të autoritetit kompetent.

AME-të duhet të mbajnë rekorde për ekzaminimet mjekësore dhe çertifikatat mjekësore të lëshuara.

AME-të duhet të mbajnë në vend të sigurt të gjitha raportet gojore dhe me shkrim, dokumentacionin mjekësor, informacionet në formë elektronike, si dhe dokumentat e tjerë që lidhen me aplikantin / mbajtësin e çertifikatës mjekësore, për sa i përket gjendjes së tij mjekësore, për qëllime të vlerësimit të mëtejshëm.

Të gjitha dokumentat mjekësore mund të bëhen të disponueshme vetëm për personat e autorizuar. Konfidencialiteti i të dhënave mjekësore duhet të respektohet gjithmonë.

Autoriteti, aplikanti / mbajtësi i një çertifikate mjekësore ose mjeku i tij personal dhe AME-të kanë qasje në këto dokumenta në përputhje me rregullat që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

Dokumenti mjekësor në bazë të të cilit është lëshuar çertifikata mjekësore duhet mbajtur 10 vite nga skadimi i një çertifikate për përshtatshmërinë mjekësore.

Dokumentacioni mjekësor në bazë të të cilit kandidati vlerësohet se nuk është i përshtatshëm duhet të mbahet 10 vjet nga data e vlerësimit mjekësor.

2.2.4. Detyrimet e AME ndaj Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar

1. Të sigurojë një kopje të të gjithë dokumentacionit të plotë mjekësor për klasat 1, 2, LAPL, pa vonesë (jo më vonë se 5 ditë pune pas ekzaminimit mjekësor) në rastin e aplikantëve për një çertifikatë mjekësore, një raport të nënshkruar ose të çertifikuar në mënyrë elektronike, që përmban rezultatet e hollësishme të ekzaminimeve dhe vlerësimeve aero-mjekësore siç kërkohet për klasën e çertifikatës mjekësore, si dhe një kopje të formularit të aplikimit, formularin e ekzaminimit dhe çertifikatën mjekësore.

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 16 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

2. Të sigurojë raporte mujore mbi ekzaminimet mjekësore të kryera për personelin e aviacionit, deri në 15 në muaj për muajin paraprak.

3. Të informojë Aviacionin Civil Shqiptar për ndryshimet në vijim:

- Nëse AME i është nënshtruar procedurave ose hetimeve disiplinore nga organi rregullator mjekësor;
- Ka ndryshime në kushtet në të cilat është marrë një çertifikatë AME, duke përfshirë përmbajtjen e dokumentave të dorëzuara;
- Nëse AME nuk i plotëson kërkesat për lëshimin, ose
- Ka një ndryshim të vendndodhjes së praktikës ose adresës së korrespondencës.

3. DISPOZITAT E ZBATUESHME/ UDHËZIME

Rregulloret Shqiptare dhe Ndërkombëtare të EU

- Udhëzimi i Ministrit Nr. 3, datë 7.2.2011, “Për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil”, që transpozon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 216/2008.

- Urdhri i Ministrit Nr. 262 datë 28.06.2019, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, që transpozon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 dhe ndryshimet e saj (Part-MED (AMC & GM) dhe Part-ARA (AMC & GM) në versionin aktual)

- Manuali i Mjekësisë së Aviacionit Civil ICAO Doc. 8984 versioni aktual.

Ekzaminuesi Aeromjekësor (AME) ka për detyrim të njihet me rregulloret dhe të njohë kushtet e kërkuara për marrjen, rivalidimin, rinovimin e çertifikatës së tij, si dhe kërkesat lidhur me çertifikimin mjekësor (dhënien, rivalidimin dhe rinovimin e çertifikatës mjekësore) të ekuipazhit ajror.

Në faqen e internetit të AAC-së, www.aac.gov.al, botohet një listë e ekzaminuesve të çertifikuar aero-mjekësorë (AMEs) dhe qendrave të çertifikuara aero-mjekësore (AeMCs) me adresa dhe kontakte.

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 17 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni Autoritetin e Aviacionit Civil në kontaktet e mëposhtme:

Telefon: +355 42 251 220

E-mail: info@acaa.gov.al

4. FORMAT

Bashkëlidhur këtij dokumenti do të gjeni të gjitha format, për t'u përdorur nga aplikantë/AME të çertifikuar dhe pilotë aplikantë për ekzaminime mjekësore.

1-O3-3.FMU/PT.001.FRM.001	6- O3-3.FMU/PT.001.FRM.006
2- O3-3.FMU/PT.001.FRM.002	7- O3-3.FMU/PT.001.FRM.007
3- O3-3.FMU/PT.001.FRM.003	8- O3-3.FMU/PT.001.FRM.008
4- O3-3.FMU/PT.001.FRM.004	9- O3-3.FMU/PT.001.FRM.009
5- O3-3.FMU/PT.001.FRM.005	10- O3-3.FMU/PT.001.FRM.010

5. ÇERTIFIKIMI AERO-MJEKËSOR

5.1 VLEFSHMËRIA E ÇERTIFIKATËS PËR PËRSHTATSHMËRINË MJEKËSORE SIPAS KLASAVE DHE PLOTËSIMI I FORMËS

TABELA E VLEFSHMËRISË SË ÇERTIFIKATAVE DHE EKZAMINIMEVE E TESTEVE TË PËRSHTATSHMËRISË AERO-MJEKËSORE				
	klasa 1	klasa 2	LAPL	klasa 3
LICENCA	CPL/MPL/ATPL	PPL/SPL/BPL	LAPL	ATCO / SATCO
KONTROLLI FILLESTAR	AeMC	AeMC/AME	AeMC/AME	AeMC

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 18 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

RIVALIDIMI (45 ditë përpara skadimit)	AeMC/AME		AeMC/AME	AeMC/AME	AeMC/AME
RINOVIMI	- Më pak se 5 vjet: AeMC/AME - Më shumë se 5 vjet: AeMC		AeMC/AME	AeMC/AME	- Më pak se 5 vjet: AeMC/AME - Më shumë se 5 vjet: AeMC
VLEFSHMËRIA E ÇERTIFIKATËS MJEKËSORE	<i>Operimet për Pilot të Vetëm të Transportit të Pasagjerëve</i> - deri në 40: 12 muaj - 40 plus: 6 muaj	<i>Operacione të tjera komerciale</i> - deri 60: 12 muaj - 60 plus: 6 muaj	- deri 40: 60 muaj (deri 42 vjeç) - 40-49: 24 muaj (deri 51 vjeç) - 50 plus: 12 muaj	- deri 40: 60 muaj, deri 42 vjeç - 40 plus: 24 muaj	- deri 40: 24 vjeç, deri 41 vjeç - 40 plus: 12 muaj
ELEKTROKARDIOGRAM (EKG)	- fillestar, më vonë - deri 30: 60 muaj - deri 40: 24 muaj - deri 50: 12 muaj - 50 plus: në çdo kontroll		- Kontrolli i parë pas moshës 40 - 50 plus: 24 muaj	Përmbajtja e kontrollit fillestar dhe çdo kontrolli pas 50 plus përfshin: (1) Shqyrtimin klinik; (2) Presionin e gjakut; (3) Urinë; (4) Kontrollin oftamologjik rutinë	- fillestar, më vonë - deri 30: 48 vjeç - më vonë në çdo kontroll
AUDIOGRAM	- fillestar, më vonë - deri 40: 60 muaj - 40 plus: 24 muaj		- Nëse PPL-së i shtohet autorizimi instrumental, fillimisht kur lëshon autorizimin, më tej: - deri në 40: 60 muaj - 40 plus: 24 muaj		- Fillestar, më vonë - deri 40: 48 muaj - 40 plus: 24 muaj

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

DËGJIMI	Rutinë në çdo kontroll	Rutinë në çdo kontroll	(shikimin); (5) Dëgjimin Përmbajtja e ekzaminimit deri në 50 përfshin: (1) Vlerësimin e historikut mjekësor	Rutinë në cdo kontroll
KONTROLL OFTAMOLOGJIK	Kontroll rutine i syrit: në çdo kontroll Ekzaminimi gjithëpërfshirës i syve: - Fillestar, Më tej: Analiza + 3D deri + 5D ose -3D deri në -6D: 60 muaj analiza tejkalon -6D: 24 muaj anisometropias ose astigmatizmi tejkalon 3D: 24 muaj	Kontroll rutine i syrit: në çdo kontroll Ekzaminimi gjithëpërfshirës i syve: - Në indikacion klinik - Nëse PPL i shtohet leja e fluturimit gjatë natës, zotëruesi duhet të jetë i sigurt për dallimin e ngjyrave!	(2) Ekzaminimin / ose vlerësimin aero- mjekësor, sipas nevojës. Nëse LAPL i shtohet leja e fluturimit gjatë natës, zotëruesi duhet të jetë i sigurt për dallimin e ngjyrave!	Kontroll rutine i syrit: në çdo kontroll Ekzaminimi gjithëpërfshirës i syve: - fillestar, më pas: +3.0/-3.0 dioptri: 48 muaj -6 dioptri; anizotropi & astigmatizmi kalon 3D: 24 muaj - Tonometri :fillestar dhe kontrolli i parë për shtyrjen e afatit pasi të mbushi 40 vjeç
HEMOGLOBINA	- në çdo kontroll	- në çdo kontroll		- fillestar - deri 40: 48 muaj - 40 plus: 24 muaj
LIPIDET	- fillestar, - Më pas në moshën 40	- Në indikacion klinik		- Në indikacion klinik

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

URINA	- në çdo kontroll	- në çdo kontroll		- në çdo kontroll
FUNKSIONET RESPIRATORE	- fillestar (FEV1/FVC), më pas në indikacion klinik	- Në indikacion klinik		- fillestar (FEV1/FVC), më pas në indikacion klinik

Forma e çertifikatës mjekësore

Formati i çertifikatës mjekësore tregohet në formën O3-3.FMU/PT.001.FRM.008.
Duhet të plotësohet në të gjitha fushat përkatëse:

- Në fushën I të shënohet autoriteti kompetent i shtetit lëshues së liçencës së pilotit (është shkruar në liçencë, të verifikohet)
- Në fushën III të shënohet numri i çertifikatës, i cili, nëse mbajtësi nuk e ka, duhet t'i kërkohet AAC-së, por vetëm për ata që mbajnë klasat 1/2/LAPL të lëshuar nga AAC, por vetëm për mbajtësit të cilëve ky Autoritet i ka lëshuar Liçencë. Mbajtësve të cilëve liçencën ua ka lëshuar një autoritet kompetent i huaj u shënohet numri i liçencës.
- Në fushën IX të shënohen të gjitha datat relevante:
- Mbajtësi i liçencës i cili ka mbushur 60 vjeç, nuk duhet të përdorë privilegjin e transportit komercial të pasagjerëve në operimet me një pilot, si rrjedhojë vlefshmëria e çertifikatës mjekësore nuk duhet të jetë shënuar si e vlefshme në fushën Klasa 1 për operate të transportit komercial me një pilot, në bazë të dispozitave FCL.065 (a) të Urdhrit të Ministrit Nr. 262 datë 28.06.2019, "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", që transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 dhe ndryshimet e saj,
- Fushat bosh të plotësohen me një vijë, në mënyrë që të evitohet shënim tjetër.

Shënim: Nëse një person humbet çertifikatën e përshtatshmërisë mjekësore dhe kërkon rilëshimin e saj, AME/AeMC mund të lëshojë një çertifikatë tjetër me një shtesë në formë "Duplikati", dhe të ndryshojë datën e lëshimit me datën aktuale. Një kopje të çertifikatës së rilëshuar duhet t'i dërgohet edhe AAC-së.

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 21 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

5.2. Kryerja e kontrolleve mjekësore për klasat 1/2/LAPL

Çertifikata aero-mjekësore për klasën 1 lëshohet për liçencat e mëposhtme:

- Licenca e pilotit të transportit ajror - ATPL,
- Pilotët profesionalë të aeroplanit dhe helikopterëve – CPL,
- Liçencë Multi - Pilot - MPL.

Çertifikat aero-mjekësore për klasën 2 lëshohen për liçencat e mëposhtme:

- Pilot privat për avion dhe helikopterë - PPL,
- Pilot për planerë – SPL, (me Pax)
- Pilot balonash - BPL. (me Pax)

Çertifikata për aftësinë shëndetësore për klasën 2 lëshohet gjithashtu për liçencat e mëposhtme:

- Pilot të avionëve ultra-të lehtë.

Çertifikata LAPL për aftësinë shëndetësore lëshohet për liçenca LAPL, dhe sipas rregulloreve kombëtare për mbajtësit e liçencave kombëtare si më poshtë:

1. Pilotë paraglajdi, me dhe pa motorr.
2. Pilotë deltaplani, me dhe pa motorr.
3. Pilotët me mjete ajrore me peshë boshe 80/100 kg.

Nëse në PPL ose LAPL shtohet kategorizimi për fluturim gjatë natës, mbajtësi i liçencës duhet të sigurohet në pamjen me ngjyra. Nëse në PPL shtohet leja për fluturim instrumental, mbajtësi i liçencës i nënshtrohet ekzaminimeve të audiometrit me ton të pastër në përputhje me periodicitetin dhe standardin e kërkuar për mbajtësit e çertifikatave mjekësore të klasës 1.

Kur të kryejë kontrollet/vlerësimet mjekësore, AME duhet të:

- 1.Sigurojë që komunikimi me personin mund të vendoset pa pengesa gjuhësore;
- 2.Ndërgjegjësojë personin për pasojat e një deklarate jo të plotë, të pasaktë ose të rreme në lidhje me historikun e tij mjekësor.

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Aplikimi për një çertifikatë mjekësore në AeMC, AME,ose GMP duhet të kryhet nëpërmjet formularëve, në varësi të klasës së çertifikatës.

Kërkesa për lëshimin e çertifikatës mjekësore të klasës 1, 2 kryhet nëpërmjet plotësimit të formularit O3-3.FMU/PT.001FRM.001

Kërkesa për lëshimin e çertifikatës mjekësore LAPL, kryhet nëpërmjet plotësimit të formularit të aplikimit O3-3.FMU/PT.001.FRM.002.

Kërkesa për lëshimin e Raportit Mjekësor për Ekuipazhin e Kabinës, kryhet nëpërmjet plotësimit të formularit të aplikimit O3-3.FMU/PT.001.FRM.009

Aplikantët për një çertifikatë mjekësore duhet të sigurojnë:

1. Letërnyoftim;
 2. Një deklaratë të nënshkruar në lidhje me historikun mjekësor, nëse janë ekzaminuar më parë për një çertifikatë mjekësore dhe, nëse po, me kë dhe me çfarë rezultati, dhe nëse ata ndonjëherë janë vlerësuar si të paaftë ose kanë një çertifikatë mjekësore të pezulluar ose revokuar (deklaratë është në formë); dhe
 3. Dorëzimin e formularit përkatës të aplikimit
- Nëse kanë aplikuar më parë për një çertifikatë mjekësore ose kanë kryer një ekzaminim aero-mjekësor për një çertifikatë mjekësore dhe, nëse po, nga kush dhe cilat kanë qënë rezultatet;
 - Nëse janë klasifikuar ndonjëherë si të papërshtashëm ose u është pezulluar ose revokuar ndonjëherë ndonjë çertifikatë mjekësore.

Kur aplikojnë për rivalidim ose rinovimin të një çertifikate mjekësore, aplikantët duhet të tregojnë tek AeMC-ja, AME-ja ose GMP-ja, një çertifikatë më të fundit mjekësore përpara ekzaminimit përkatës (një kopje të dorëzohet me dokumentacionin mjekësor).

Kërkesat që duhet të përmbushen nga aplikantët për çertifikatat mjekësore të pilotëve përcaktohen në Pjesën e MED të Urdhrit të Ministrit Nr. 262 datë 28.06.2019, “Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, që transponon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 1178/2011 dhe ndryshimet e saj, Part-MED (AMC & GM) dhe Part-ARA (AMC & GM) në versionin aktual (shiko Shtojcën 1).

Një çertifikatë mjekësore lëshohet, rivlerësohet ose rinovohet vetëm pasi të jenë kryer ekzaminimet dhe vlerësimet e nevojshme aero-mjekësore, sipas rastit, dhe aplikanti të jetë vlerësuar si i përshtashëm.

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 23 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Lëshimi fillestar

- Një çertifikatë mjekësore e klasës 1 duhet të kryhet nga një AeMC.
- Çertifikatat mjekësore të klasës 2 lëshohen nga një AeMC ose nga një AME.
- Çertifikatat mjekësore të LAPL lëshohen nga një AeMC ose nga një AME. Gjithashtu, ato mund të lëshohen edhe nga një GMP, nëse lejohet nga ligjet kombëtare të shtetit të autoritetit liçencues ku është bërë kërkesa për çertifikatën mjekësore.

Rivlerësimi dhe rinovimi

- Çertifikatat mjekësore të klasës 1 dhe 2 rivlerësohen dhe rinovohen nga një AeMC ose nga një AME.
- Çertifikatat mjekësore të LALP rivlerësohen dhe rinovohen nga një AeMC ose nga një AME. Ato gjithashtu mund të rivlerësohen dhe rinovohen edhe nga një GMP, nëse lejohet nga ligjet kombëtare të shtetit të autoritetit liçencues ku është bërë kërkesa për çertifikatën mjekësore.

AeMC, AME ose GMP-të do të lëshojnë, rivalidojnë ose rinovojnë një çertifikatë mjekësore nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- Aplikanti ka vendosur në dispozicion një historik të plotë mjekësor dhe, nëse kërkohet nga AeMC, AME ose GMP, me rezultatet e ekzaminimeve mjekësore dhe analizave të kryera nga mjeku i aplikantit ose ndonjë specialist mjekësor;
- AeMC, AME ose GMP ka kryer vlerësimin aero-mjekësor në bazë të ekzaminimeve dhe analizave mjekësore siç kërkohet për çertifikatën përkatëse mjekësore për të verifikuar që aplikanti është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të Pjesës-MED.

AME-ja, AeMC-ja ose, në rastin e një rasti të referuar, vlerësuesi mjekësor i autoritetit të liçencimit mund të kërkojë nga aplikanti që t'i nënshtrohet ekzaminimeve dhe hetimeve mjekësore shtesë kur ka një tregues klinik ose epidemiologjik para lëshimit, rivalidimit ose rinovimit të çertifikatës mjekësore.

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Vlefshmëria, rinovimi dhe rivalidimi i çertifikatave mjekësore.

Periudha e vlefshmërisë së një çertifikate mjekësore, përfshirë çdo ekzaminim shoqërues ose ekzaminim special, do të:

- përcaktohet nga mosha e aplikantit në ditën kur është bërë ekzaminimi mjekësor; dhe
- llogaritet nga data e ekzaminimit mjekësor në rast të lëshimit fillestar dhe rinovimit, dhe nga data e skadimit të çertifikatës së mëparshme të aftësisë mjekësore në rastin e zgjatjes së afatit. Një çertifikatë mjekësore e Klasës 1 do të jetë e vlefshme për një periudhë 12 muaj.

Periudha e vlefshmërisë së një çertifikate mjekësore të Klasës 1 do të zvogëlohet në 6 muaj nga mbajtësit e liçencave të cilët:

- janë të përfshirë në operimet komerciale të transportit ajror me një pilot, që transportojnë pasagjerë dhe që janë mbi 40 vjeç;
- kanë kaluar moshën 60 vjeç.

Një çertifikatë mjekësore e Klasës 2 do të jetë e vlefshme për periudhën nga:

- 60 muaj para se i liçencuari të mbushë moshën 40 vjeç. Një çertifikatë mjekësore e lëshuar mbajtësit të liçencës para moshës 40 vjeç do të pushojë së qënuri e vlefshme pasi mbajtësi i liçencës të mbushë moshën 42 vjeç;
- 24 muaj midis 40 dhe 50 vjeç. Çertifikata Mjekësore e lëshuar para moshës 50 vjeç do të pushojë së qënuri e vlefshme kur mbajtësi i liçencës të ketë mbushur moshën 51 vjeç; dhe
- 12 muaj pas moshës 50 vjeç.

Çertifikata e shëndetit LAPL do të jetë e vlefshme për periudhën nga:

- 60 muaj derisa i liçencuari të mbushë moshën 40 vjeç. Një çertifikatë mjekësore e lëshuar mbajtësit të liçencës para moshës 40 vjeç do të pushojë së qënuri e vlefshme kur mbajtësi i liçencës të ketë mbushur moshën 42 vjeç;
- 24 muaj pas moshës 40 vjeç.

Periudha e vlefshmërisë së një çertifikate mjekësore, duke përfshirë çdo ekzaminim në lidhje me të ose hetim të veçantë, llogaritet nga data e ekzaminimit aero-mjekësor në rastin e lëshimit për herë të parë dhe rinovimit dhe nga data e skadimit të çertifikatës së mëparshme mjekësore në rastin e rivlerësimit.

Rivalidimi

Ekzaminimet dhe vlerësimet aero-mjekësore, sipas rastit, për rivalidimin e çertifikatës mjekësore mund të ndërmerren deri në 45 ditë përpara datës së skadimit të çertifikatës mjekësore

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 25 nga 158
-----------------------------	------------------	------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

Rinovimi

Nëse mbajtësi i një çertifikate mjekësore nuk është në përputhje me kërkesat e rivalidimit të lartpërmëndur, kërkohet ekzaminimi dhe vlerësimi i rinovuar, sipas rastit.

Në rastin e çertifikatave mjekësore të klasës 1 dhe 2:

- nëse çertifikata e shëndetit ka skaduar për më pak se 2 vjet, AeMC ose AME duhet vetëm të kryejë një ekzaminim aero-mjekësor rutinë të rivalidimit;
- nëse çertifikata mjekësore ka skaduar më shumë se 2 vjet, por më pak se 5 vjet, AeMC ose AME do të zhvillojë kërkesat e rinovimit për ekzaminimet aero-mjekësore, pas vlerësimit të dosjes mjekësore të aplikantit;
- nëse çertifikata mjekësore ka skaduar për më shumë se 5 vite, do të aplikohen kërkesat për ekzaminime aero-mjekësore të lëshimit fillestar dhe vlerësimet do të kryhen duke u bazuar në kërkesat e rivalidimit.

Në rastin e një Çertifikate të Shëndetit LAPL, AeMC, AME ose GMP-të duhet të vlerësojnë historikun mjekësor të aplikantit dhe të kryejnë një ekzaminim dhe / ose vlerësim aero-mjekësor në përputhje me MED.B.005 dhe MED.B.095.

Kufizimet për klasën 1/2/LAPL

Kufizimet për klasën 1/2/LAPL			
Kod	Kufizime	UNOS	Eliminim
TML	Kufizimi i periudhës së vlefshmërisë së çertifikatës mjekësore Restriction of the period of validity of the medical certificate	AME/AeMC	Për klasën 1, të gjitha kufizimet mund të hiqen vetëm nga AME!
VDL	Korrigjimi për shikimin në largësi të dëmtuar <i>Correction for defective distant vision</i>	AME/AeMC	Për klasën 2, të

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

VML	Korrigjimi për shikim të largët, të ndërmjetëm dhe të afërt <i>Correction for defective distant, intermediate and nearvision</i>	AME/AeMC	gjitha kufizimet mund të hiqen në konsultim me AME! Për çertifikimin LAPL, kufizimet mund të fshihen
VCL	E vlefshme vetëm gjatë ditës <i>Valid by day only</i>	AME/AeMC	
VNL	Korrigjimi i shikimit në afërsi <i>Correction for defective near vision</i>	AME/AeMC	
CCL	Korrigjim vetëm nëpërmjet lenteve <i>Correction by means of contact lenses only</i>	Klasa 1 - Vlerësuesi mjekësor i Autoritetit-referal Klasa 2 - AME/AeMC në konsultë me Vlerësuesin	
HAL	E vlefshme vetëm duke përdorur aparate dëgjimi <i>Valid only when hearing aids are worn</i>	Klasa 1 - Vlerësuesi mjekësor i Autoritetit-referal Klasa 2 - AME/AeMC në konsultë me Vlerësuesin	
MED.B.035 Sistemi urogjenital (a) Analizat e urinës janë pjesë e çdo ekzaminimi aero-mjekësor. Aplikantët vlerësohen si të papërshtatshëm kur urina e tyre përmban elementë anormalë që konsiderohen të jenë patologjike që mund të shkaktojnë një shkallë të paaftësisë funksionale që mund të rrezikojë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të liçencës ose mund të bëjë që aplikanti të jetë papritur i paaftë për të ushtruar këto privilegje. (b) Aplikantët me ndonjë pasojë të sëmundjes ose ndërhyrjes kirurgjike në sistemin urogjenital ose kur adneksa e tij mund të shkaktojë paaftësi, në veçanti çdo pengesë për shkak të shtrëngimit ose ngjeshjes, klasifikohen si të papërshtatshëm. (c) Aplikantët me historik mjekësor ose diagnozë të sëmundjeve të mëposhtme mund të klasifikohen si jo të papërshtatshëm, sipas vlerësimit të imtësishëm urogjenital, sipas rastit: (1) sëmundje të veshkave;	AMC1 MED.B.035 Sistemi gjenitourinar (a) Analiza jonormale e urinës Egzaminimi kërkohet nëse ka ndonjë gjetje jonormale për urinalizën. (b) Sëmundjet renale (1) Aplikantët që paraqesin ndonjë shenjë të sëmundjes renale duhet të vlerësohen si të papërshtatshme. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse presioni i gjakut është i kënaqshëm dhe funksionet renale janë të pranueshme. (2) Aplikantët me kërkesa për dializë shpallen të papërshtatshëm. (c) Gurët urinare (1) Aplikantët me një gur asimptomatik ose një histori të kalkulozës renale kërkojnë hetim. (2) Aplikantët që paraqesin me një apo më shumë gurë urinar duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm dhe kërkojnë hetim. (3) Një vlerësim i përshtatshëm me një kufizim me shumë pilot mund të konsiderohet gjatë pritjes së vlerësimit ose trajtimit. (4) Një vlerësim i përshtatshëm me kufizim	AMC2 MED.B.035 Sistemi gjenitourinar (a) Sëmundjet renale (veshkat) Aplikantët që paraqesin sëmundje renale mund të vlerësohen si të përshtatshëm nëse presioni i gjakut është i kënaqshëm dhe funksionet renale janë të pranueshme. Kërkesa për dializë është skualifikuese. (b) Gurët urinare (1) Aplikantët që paraqesin me një apo më shumë gurë urinare duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. (2) Aplikantët me një gur asimptomatik ose një histori të kolikes renale kërkojnë hetim. (3) Në pritje të vlerësimit ose trajtimit, mund të merret në konsideratë një vlerësim i përshtatshëm me një kufizim piloti të sigurisë. (4) Pas trajtimit të suksesshëm, aplikanti mund të vlerësohet i përshtatshëm. (5) Aplikantët me gurët e mbetur parenkimal mund të vlerësohen si të përshtatshëm. (c) Kirurgjia renale / urologjike Aplikantët të cilët kanë pësuar një operacion të madh kirurgjik në traktin urinar ose në
---	--	--



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

(2) një ose më shumë gurë në rrugët urinare ose historik mjekësor të kolikut të veshkave;

(d) Aplikantët që kanë kryer një ndërhyrje kirurgjikale në sistemin urogjenital ose në adneksën e tij që përfshin prerjen e plotë ose të pjesshme ose devijimin e organeve klasifikohen si të përshtatshëm. Gjithsesi, pas rikuperimit të plotë ata mund të vlerësohen si të përshtatshëm nga ana mjekësore

(e). Aplikantët për çertifikatë mjekësore të klasës 1 të përmendur në pikat (c) dhe (d) i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçencues.

OML mund të konsiderohet pas trajtimit të suksesshëm për një gur.

(5) Aplikantët me gurë të mbetur, mund të merren në konsideratë për një vlerësim të përshtatshëm me një kufizim OML.

(d) Kirurgji renale / urologjike

(1) Aplikantët të cilët kanë pësuar një operacion të madh kirurgjik në traktin urinar ose në aparatën urogjenital që përfshijnë një prerje totale ose të pjesshme ose një devijim të ndonjë prej organeve të tij duhet të vlerësohen si të përshtatshëm për një periudhë minimale prej 3 muajsh ose deri në kohën kur efektet e operacionit nuk kanë më gjasa të shkaktojnë paaftësi gjatë fluturimit.

(2) Pas kirurgjisë urologjike, mund të merret një vlerësim i përshtatshëm nëse aplikanti është krejtësisht asimptomatik dhe ekziston rreziku minimal i ndërlikimeve dytësore ose përsëritjes.

(3) Për një vlerësim të përshtatshëm mund të konsiderohet një aplikant me nefrektomi të kompensuar pa hipertension ose uremi.

aparatin urogjenital që përfshijnë një prerje totale ose të pjesshme ose një devijim të ndonjë prej organeve të tij, duhet të vlerësohen si të përshtatshëm deri në kohën kur efektet e operacionit nuk ka gjasa të shkaktojnë paaftësi gjatë fluturimit. Pas kirurgjisë urologjike, mund të merret në konsideratë një vlerësim i përshtatshëm nëse aplikanti është krejtësisht asimptomatik, ekziston rreziku minimal i komplikimeve dytësore ose recidivave që paraqiten me sëmundjen renale, nëse presioni i gjakut është i kënaqshëm dhe funksioni renal është i pranueshëm. Kërkesa për dializë është skualifikuese.

(2) Një aplikant me nefrektomi të kompensuar pa hipertension ose uremi mund të vlerësohet si i përshtatshëm.

(3) Aplikantët që kanë bërë transplant të veshkave mund të konsiderohen për një vlerësim të përshtatshëm nëse kompensohet plotësisht dhe me vetëm terapi minimale immuno-shtypëse.

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

	(4) Aplikantët që kanë bërë transplantim të veshkave mund të konsiderohen për një vlerësim të përshtatshëm nëse kompensohet plotësisht dhe tolerohet me vetëm terapinë minimale imunopresive pas së paku 12 muajsh. Aplikantët mund të vlerësohen si të përshtatshëm me një kufizim me shumë pilot. (5) Aplikantët që kanë pësuar cistektominë totale mund të konsiderohen për një vlerësim të përshtatshëm me OML nëse ka funksionin e urinimit të kënaqshëm, pa infeksion dhe pa përsëritje të patologjisë fillestare.	Aplikantët të cilët kanë bërë cistektominë totale mund të konsiderohen për një vlerësim të përshtatshëm nëse ka funksion urinar të kënaqshëm, pa infeksion dhe pa përsëritje të patologjisë primare.
MED.B.040 Sëmundjet infektive (a) Aplikantët klasifikohen si të papërshtatshëm kur ata kanë një diagnozë klinike ose historik mjekësor të ndonjë sëmundjeje infektive që mund të rrezikojë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të liçencës. (b) Aplikantët me HIV pozitiv mund të klasifikohen si të papërshtatshëm, duke iu nënshtuar analizave të imtësishme aero-mjekësore. Këta aplikantë për çertifikatë mjekësore të klasës 1 i referohen vlerësuesit	AMC1 MED.B.040 Sëmundjet infektive (a) Sëmundja infektive. Të përgjithshme Në rastet e sëmundjeve infektive, duhet të merret në konsideratë një historik ose shenja klinike që tregojnë dëmtimin themelor të sistemit imunitar. (b) Tuberkulozi Aplikantët me tuberkuloz aktiv duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas përfundimit të terapisë.	AMC2 MED.B.040 Sëmundjet infektive (A) Tuberkulozi Aplikantët me tuberkuloz aktiv duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm deri në përfundimin e terapisë. (b) Infeksioni HIV Një vlerësim i përshtatshëm mund të



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

mjekësor të autoritetit liçencues.

(c) Sifilizi

Sifilizi akut është skualifikues (unfit). Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet në rastin e atyre që trajtohen plotësisht dhe mbulohen nga fazat fillestare dhe dytësore.

(d) Infeksioni HIV

(1) Aplikanti me HIV pozitiv mund të vlerësohet i përshtatshëm me një kufizim OML nëse një hetim i plotë nuk jep dëshmi të sëmundjeve të lidhura me HIV që mund të shkaktojnë simptoma paaftësie. Shqyrtimi i shpeshtë i statusit imunologjik dhe vlerësimit neurologjik duhet të kryhet nga një specialist i duhur. Një vlerësim kardiologjik gjithashtu mund të kërkohet, në varësi të ilaçeve.

(2) Aplikanti me shenja ose simptoma të një gjendje përcaktuese të SIDA-s duhet të konsiderohet jo i përshtatshëm.

(e) Hepatiti infektiv

Hepatiti infektiv është skualifikues. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pasi aplikanti është bërë asimptomatik. Vizita të rregullta të funksioneve të mëlcisë duhen

konsiderohet për individë HIV pozitivë me sëmundje të qëndrueshme, jo progresive, nëse hetimi i plotë nuk ofron prova të sëmundjeve të lidhura me HIV, të cilat mund të shkaktojnë simptoma skualifikuese.

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

	kryer.	
MED.B.045 Obstetrika dhe Gjinekologjia (a) Aplikantët të cilët kanë kryer një operacion gjinekologjik klasifikohen si të papërshtatshëm. Gjithsesi, ata mund të klasifikohen si të aftë për punë pas rikuperimit të plotë. (b) Shtatëzania (1) Në rast shtatëzanie, një aplikante mund të vazhdojë ushtrimin e privilegjeve të saj deri në fund të javës së 26 të shtatëzanisë vetëm nëse një AeMC ose AME gjykon se ajo është e aftë për t'a bërë këtë. (2) Për mbajtëset e çertifikatës mjekësore të klasës 1 që janë shtatëzanë, aplikohet OML-ja. Pavarësisht nga pika MED.B.001, në atë rast OML-ja mund të vendoset dhe të hiqet nga një AeMC ose AME. (3) Një aplikante mund të rifillojë ushtrimin e privilegjeve të saj pas rikuperimit pas përfundimit të shtatëzanisë.	AMC1 MED.B.045 Obstetrikë dhe gjinekologji (a) Kirurgjia gjinekologjike Një aplikant i cili ka pësuar një operacion të madh gjinekologjik duhet të vlerësohet si i papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse rikuperimi është i plotë, aplikanti është asimptomatik, risku i komplikacioneve dhe rikthimit të jetë minimal (C) Shtatëzania (1) Një mbajtës shtatëzanë i licencës mund të vlerësohet si i përshtatshëm me një kufizim OML gjatë 26 javëve të para të shtatëzanisë, pas shqyrtimit të vlerësimit të kënaqshëm obstetrik (2) Privilegjet e licencës mund të rifillohen pas konfirmimit të kënaqshëm të rimëkëmbjes së plotë, pas mbylljes ose përfundimit të shtatëzanisë.	AMC2 MED.B.045 Obstetrikë dhe gjinekologji (a) Kirurgji gjinekologjike Një aplikant i cili ka pësuar një operacion të madh gjinekologjik duhet të vlerësohet i papërshtatshëm derisa efektet e operacionit nuk do të pengojnë ushtrimin e sigurt të privilegjeve të licencës. (B) Shtatëzania (1) Një mbajtës shtatëzanë i licencës mund të vlerësohet i përshtatshëm gjatë 26 javëve të para të shtatëzanisë pas vlerësimit të kënaqshëm obstetrik. (2) Privilegjet e licencës mund të rifillojnë me konfirmimin e kënaqshëm të rikuperimit të plotë pas mbylljes ose ndërprerjes së shtatëzanisë.
MED.B.050 Sistemi Muskoskeletor (a) Aplikantët të cilët nuk janë të gjatë	AMC1 MED.B.050 Sistemi muskuloskeletal	AMC2 MED.B.050 Sistemi muskuloskeletal



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

mjaftueshëm kur ulen, gjatësi të krahëve ose këmbëve dhe forcë muskulore për ushtrimin e sigurt të privilegjeve të liçencës klasifikohen si të papërshtatshëm. Megjithatë, nëse lartësia kur ulet, gjatësia e krahëve dhe këmbëve dhe forca muskulore është e mjaftueshme për ushtrimin e sigurt të privilegjeve në lidhje me një lloj të caktuar avioni, çka mund të provohet sipas nevojës përmes një fluturimi mjekësor ose një testi të simulimit të fluturimit, aplikantja mund të klasifikohet si jo e papërshtatshme dhe privilegjet e saj kufizohen në përputhje me rrethanat.

(b) Aplikantët me funksion jo të kënaqshëm të sistemit muskuloskeletor që i pengon ata të ushtrojnë në mënyrë të sigurt privilegjet e liçencës, klasifikohen si të papërshtatshëm. Megjithatë, nëse përdorimi funksional i sistemit të tyre muskulo-skeletor është i mjaftueshëm për ushtrimin e sigurt të privilegjeve në lidhje me një lloj të caktuar avioni, çka mund të provohet sipas nevojës

(a) Një aplikant me pasoja të rëndësishme nga sëmundja, dëmtimi ose anomali të lindura që prekin kockat, artikulacionet, muskujt ose tendinet me ose pa kirurgji kërkon vlerësim të plotë para një vlerësimi të përshtatshëm.

(b) Një aplikues me sëmundje inflamatore, infiltrative, traumatike ose degjeneruese të sistemit muskuloskeletal mund të vlerësohet si i përshtatshëm me kusht që gjendja të jetë në remision dhe aplikanti nuk merr mjekim skualifikues dhe ka përfunduar në mënyrë të kënaqshme një test mjekësor fluturimi ose test të fluturimit në simulator. Kufizime të duhura aplikohen.

(c) Aplikantët me sistem skeletor muskolor jonormal, përfshirë obezitetin, që ndërmarrin një test mjekësor fluturimi ose test të fluturimit në simulator duhet të kryejnë në mënyrë të kënaqshme të gjitha detyrat e kërkuara për llojin e fluturimit të destinuar, përfshirë procedurat e emergjencës dhe evakuimit.

(a) Një aplikues me ndonjë pasojë trupore nga sëmundja, dëmtimi ose anomali i lindur që prekin kockat, artikulacionet, muskujt ose tendinet me ose pa kirurgji kërkon vlerësim të plotë para një vlerësimi të përshtatshëm.

(b) Në rastet e mungesës së gjymtyrëve, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas një prove të kënaqshme mjekësore të fluturimit.

(c) Një aplikues me sëmundje inflamatore, infiltrative, traumatike ose degjenerative të sistemit muskuloskeletal mund të vlerësohet si i përshtatshëm, me kusht që gjendja të jetë në përmirësim dhe aplikanti nuk merr medikamente skualifikuese dhe ka kryer në mënyrë të kënaqshme testin e fluturimit mjekësor. Mund të kërkohej një kufizim për tipin(et) e avionit, të specifikuar.

Trupi jonormal ose dobësia muskulare mund të kërkojnë një test të kënaqshëm të fluturimit mjekësor. Mund të kërkohej një kufizim për tipin(et) e avionit, të specifikuar.

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

përmes një fluturimi mjekësor ose një testi të simulimit të fluturimit, aplikantja mund të klasifikohet si jo e papërshtatshme dhe privilegjet e saj kufizohen në përputhje me rrethanat. (c) Në raste kur ngrihen dyshime në kontekstin e vlerësimit të përmendur në pikat (a) dhe (b), aplikantët për çertifikatë mjekësore të klasës 1 i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçencues dhe aplikantët për çertifikatë mjekësore të klasës 2 vlerësohen në konsultim me vlerësuesin mjekësor të autoritet liçencues.		
MED.B.055 Shëndeti Mendor (a) Vlerësimi gjithëpërfshirës i shëndetit mendor është pjesë e ekzaminimit aero-mjekësor fillestar të klasës 1. (b) Analizat për drogë dhe alkool janë pjesë e ekzaminimit aero-mjekësor fillestar të klasës 1. (c) Aplikantet me çrregullime mendore ose të sjelljes për shkak të përdorimit ose keqpërdorimit të alkoolit ose substancave të	AMC1 MED.B.055 Shëndeti Mendor (a) Vlerësimi i shëndetit mendor si pjesë e vlerësimit fillestar aero-mjekësor të klasës 1 (1) Një vlerësim gjithëpërfshirës i shëndetit mendor duhet të bëhet dhe regjistrohet duke marrë marrë parasysh kontekstet sociale, mjedisore dhe kulturore. (2) Historiku i aplikantit dhe simptomat e çrregullimeve që mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e fluturimit duhet të	AMC1 MED.B.055 Shëndeti Mendor (a) Vlerësimi i shëndetit mendor si pjesë e ekzaminimit aero-mjekësor të klasës 2 (1) Një vlerësim i shëndetit mendor duhet të bëhet dhe regjistrohet duke marrë parasysh kontekstet sociale, mjedisore dhe kulturore. (2) Historiku i aplikantit dhe simptomat e çrregullimeve që mund të përbëjnë një kërcënim për sigurinë e fluturimit duhet të identifikohen dhe regjistrohen.



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

tjera psikoaktive klasifikohen si të papërshtatshëm në pritje të shërimit dhe çlirimit nga përdorimi ose keqpërdorimi i substancave psikoaktive dhe duke iu nënshtuar analizave të mëtejshme të imtësishme psikiatrike pas trajtimit me sukses.

(d) Aplikantët me diagnozë klinike ose historik mjekësor të dokumentuar të një prej kushteve të mëposhtme psikiatrike i nënshtrohen vlerësimeve të imtësishme psikiatrike para se të klasifikohen si të papërshtatshëm :

(1) çrregullim i humorit;

(2) çrregullime neurotike;

(3) çrregullime personaliteti;

(4) çrregullime mendore dhe në sjellje;

(5) keqpërdorimi i substancave psikoaktive.

(e) Aplikantët me historik mjekësor të dokumentuar të akteve deliruese të vetë-dëmtimit të qëllimshëm qoftë në një rast të vetëm ose të përsëritur, klasifikohen si të papërshtatshëm . Megjithatë, ata mund të

identifikohen dhe regjistrohen.

(3) Vlerësimi i shëndetit mendor duhet të përfshijë vlerësimin dhe dokumentacionin e:

(i) qëndrimeve të përgjithshme ndaj shëndetit mendor, përfshirë kuptimin e indikacioneve të mundshme të reduktuar të shëndetit mendor në veten e tyre dhe të tjerët;

(ii) strategjive të përballimit në periudha të stresit psikologjik ose presionit në të kaluarën, përfshirë kërkimin e këshillave nga të tjerët;

(iii) problemeve të sjelljes në fëmijëri;

(iv) çështjeve ndërpersonale dhe marrëdhënieve;

(v) stresorëve aktualë të punës dhe të jetës; dhe

(vi) çrregullimeve të dukshme të personalitetit.

(4) Kur ka shenja ose vërtetohet se një aplikant mund të ketë çrregullim psikiatrik ose psikologjik, aplikanti duhet të drejtohet për mendim dhe këshilla tek specialisti.

(b) Vlerësimi i shëndetit mendor si pjesë e rivlerësimit ose rinovimit të vlerësimit

(3) Kur ka shenja ose vërtetohet se një aplikant mund të ketë çrregullim psikiatrik ose psikologjik, aplikanti duhet të drejtohet për mendim dhe këshilla tek specialisti.

(4) Provat e krijuara duhet të jenë informacione të verifikueshme nga një burim i identifikueshëm i lidhur me aftësinë mendore ose personalitetin e një individi të veçantë. Burimet për këtë informacion mund të jenë aksidente ose incidente, probleme në trajnime ose kontrole të aftësive, sjellje ose njohuri të rëndësishme për ushtrimin e sigurt të privilegjeve të liçencës (ave) të aplikueshme.

(b) Vlerësimi i mbajtësve të një çertifikate mjekësore të klasit 2 të referuar në MED.B.055 (d) mund të kërkojë vlerësim psikiatrik dhe psikologjik siç përcaktohet nga AME, AeMC ose vlerësuesi mjekësor i autoritetit liçencues. Ndjekja, sipas nevojës, duhet të përcaktohet në konsultim me vlerësuesin mjekësor të autoritetit liçencues.

(c) Vendimet e vlerësimit dhe referimit

(1) Çrregullimi psikotik



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

klasifikohen si të papërshtatshëm pas vlerësimit të imtësishëm psikiatrik. (f) Vlerësimi aero-mjekësor (1) Aplikantët për çertifikatat mjekësore të klasës 1, të cilët vuajnë nga ndonjë prej kushteve të specifikuara në pikën (c), (d) ose (e), i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçencues. (2) Aftësia për punë e aplikantëve që aplikojnë për çertifikatat mjekësore të klasës 2, të cilët vuajnë nga ndonjë prej kushteve të specifikuara në pikën (c), (d) ose (e), vlerësohen duke u konsultuar me vlerësuesin mjekësor të autoritetit liçencues. (g) Aplikantët me një historik mjekësor të dokumentuar ose diagnozë klinike të skizofrenisë, çrregullimeve skizotipale ose delusionale klasifikohen si të papërshtatshëm. (1) Aplikantët për çertifikatë mjekësore të klasit të parë që i përkasin njërës prej kategorive të detajura më sipër në pikën b, c	mjekësor të klasës 1 (1) Vlerësimi duhet të përfshijë rishikimin dhe dokumentacionin e: (i) stresorëve aktualë të punës dhe të jetës; (ii) strategjive të përballimit në periudha të stresit psikologjik ose presionit në të kaluarën, përfshirë kërkimin e këshillave nga të tjerët; (iii) çdo vështirësi në menaxhimin operacional të burimeve të ekuipazhit (CRM); (iv) çdo vështirësi me punëdhënësin dhe / ose kolegët dhe menaxherët e tjerë; dhe (v) çështjeve ndërpersonale dhe marrëdhënieve, përfshirë vështirësitë me të afërmit, miqtë dhe kolegët e punës. (2) Kur ka shenja ose vërtetohet se një aplikant mund të ketë çrregullim psikiatrik ose psikologjik, aplikanti duhet të drejtohet për mendim dhe këshilla tek specialisti. (3) Evidencat e krijuara duhet të jenë informacione të verifikueshme nga një burim i identifikueshëm i lidhur tek aftësia mendore	Aplikantët me një historik ose shfaqje të një çrregullimi psikotik funksional duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse një shkak mund të jetë identifikuar pa mëdyshje si kalimtare, ka pushuar dhe rreziku i përsëritjes është minimal. (2) Çrregullimi mendor organik Aplikantët me një çrregullim mendor organik duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Pasi shkakun të jetë trajtuar, një aplikant mund të vlerësohet si i përshtatshëm pas vlerësimit psikiatrik të kënaqshëm. (3) Skizofrenia, çrregullimi skizotipal ose delusional Aplikantët me një histori të vendosur ose diagnozë klinike të skizofrenisë, skizotipale ose çrregullim delirues mund të konsiderohen vetëm për një vlerësim të përshtatshëm në konsultim me vlerësuesin mjekësor të autoritetit liçencues nëse diagnoza origjinale ishte e papërshtatshme ose e pasaktë siç konfirmohet nga vlerësimi psikiatrik, ose, në
--	---	---



Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

ose d, duhet t'i referohen autoritetit liçencues.

(2)Përshtatshmëria e klasit të dytë për aplikantët që i përkasin njërës nga klasat e detajuara më sipër në pikën b,c ose do të vlerësohen në konsultim me autoritetin liçencues.

(f)Aplikantët me një historik të sajuar ose diagnoza klinike të skizofrenisë, çrregullime dilusionale do të vlerësohen si të papërshtatshëm.

ose personaliteti i një individi të veçantë. Burimet për këtë informacion mund të jenë aksidente ose incidente, probleme në trajnime ose kontrole të aftësive, sjellje ose njohuri të rëndësishme për ushtrimin e sigurt të privilegjeve të liçencës (ave) të aplikueshme.

(c) Vlerësimi i mbajtësve të një çertifikate mjekësore të klasit 1 të referuar në MED.B.055 (d)

Vlerësimi i mbajtësve të një çertifikate mjekësore të klasit 1 të referuar në MED.B.055 (d) mund të kërkojë vlerësimin psikiatrik dhe psikologjik siç përcaktohet nga vlerësuesi mjekësor i autoritet të licencimit. Një kufizim SIC duhet të vendoset në rast të një vlerësimi të përshtatshëm. Ndjekja dhe heqja e kufizimit të SIC, sipas nevojës, duhet të përcaktohet nga vlerësuesi mjekësor në autoritetin liçencues.

(d) Testimi i substancave psikoaktive

(1) Testet e drogës duhet të kontrollojnë opioidet, kanabinoidet, amfetaminet, kokainën,halucinogjenet dhe hipnotikët qetësues. Pas një vlerësimi të rrezikut të kryer

rastin e një episodi të vetëm të deliriumit, shkakut i të cilit ishte i qartë, me kusht që aplikanti të mos ketë pësuar dëmtim të përhershëm mendor.

(4) Çrregullimi i humorit

Aplikantët me një çrregullim të vendosur të humorit duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Pas rimëkëmbjes së plotë dhe pas shqyrtimit të plotë të çështjes individuale, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet, në varësi të karakteristikave dhe ashpërsisë së çrregullimit të humorit.

(5) Çrregullimi neurotik, i lidhur me stresin ose somatoform

Kur ka shenja ose vërtetohet prova që një aplikant mund të ketë një çrregullimi neurotik, të lidhur me stresin ose somatoform, aplikanti duhet të drejtohet për marrje mendimi dhe këshilla psikiatrike.

(6) Çrregullimet e personalitetit ose sjelljes

Kur ka shenja ose është vërtetuar me prova që një aplikant mund të ketë çrregullim të personalitetit ose sjelljes, aplikanti duhet të



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

nga autoriteti kompetent për popullatën e synuar, testet e shqyrtimit mund të përfshijnë droga shtesë.

(2) Për rinovimin / rivlerësimin, mund të kryhet testi i rastësishëm i shqyrtimit të substancave psikoaktive bazuar në vlerësimin e rrezikut nga autoriteti kompetent në popullatën e synuar. Nëse merret në konsideratë testi i shqyrtimit të rastësishëm të depistimit psikoaktiv të substancave psikologjike ai duhet kryer dhe raportuar në përputhje me procedurat e zhvilluara nga autoriteti kompetent.

(3) Në rastin e një rezultati pozitiv të kontrollit të substancave psikoaktive, konfirmimi duhet të kërkohej në përputhje me standardet dhe procedurat kombëtare për testimin e substancave psikoaktive.

(4) Në rast të një testi të konfirmimit pozitiv, duhet të bëhet një vlerësim psikiatrik para se te mund të konsiderohet një vlerësim i përshtatshëm nga vlerësuesi mjekësor i

drejtohet për marrje mendimi dhe këshilla psikiatrike.

(7) Medikamentet psikoaktive

Aplikantët që përdorin ilaçe psikoaktive që mund të ndikojnë në sigurinë e fluturimit duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Nëse konfirmohet qëndrueshmëria në mjekimin psikoaktiv të mirëmbajtjes, një vlerësim i përshtatshëm me një OSL ose OPL mund të konsiderohet. Nëse doza ose lloji i ilaçeve është ndryshuar, duhet të kërkohej një periudhë e mëtejshme e vlerësimit të papërshtatshëm deri sa të jetë konfirmuar stabiliteti.

(8) Çrregullime për shkak të përdorimit ose keqpërdorimit të alkoolit ose substancave të tjera psikoaktive

(i) Aplikantët me çrregullime mendore ose të sjelljes për shkak të alkoolit ose përdorimit apo keqpërdorimit të substancave psikoaktive, me ose pa varësi, duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm.

(ii) Testet e drogës dhe alkoolit



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

autoritetit të licencimit.

(e) Vendimet e vlerësimit dhe referimit

(1) Çrregullimet psikotike

Aplikantët me një historik ose shfaqje të një çrregullimi psikotik funksional duhet të vlerësohen si jo të përshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse një shkak mund të jetë pa mëdyshje i identifikuar si kalimtar, është stopuar dhe rreziku i përsëritjes është minimal.

(2) Çrregullimi mendor organik

Aplikantët me një çrregullim mendor organik duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Pasi shkaku të jetë trajtuar, një aplikant mund të vlerësohet si i përshtatshëm pas vlerësimit psikiatrik të kënaqshëm.

(3) Medikamentet psikoaktive

Aplikantët që përdorin ilaçe psikoaktive që mund të ndikojnë në sigurinë e fluturimit duhet të vlerësohen si jo të përshtatshëm. Nëse konfirmohet qëndrueshmëria në mbajtjen e mjekimit psikoaktiv, një vlerësim i përshtatshëm me një OML mund të

(A) Në rastin e një rezultati pozitiv të testit të drogës ose alkoolit, duhet kërkuar konfirmimi në përputhje me procedurat kombëtare për testimin e drogës dhe alkoolit.

(B) Në rast të një testi të konfirmimit pozitiv, duhet të bëhet një vlerësim psikiatrik i cili ndërmerret para se të mund të merret në konsideratë një vlerësim i përshtatshëm.

(iii) Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas një periudhe dy vjeçare të dokumentuar të të qenurit esëll ose të çliruar nga përdorimi ose keqpërdorimi i substancave psikoaktive. Në rivlerësimin ose rinovimin, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet më parë me një OSL ose OPL. Në varësi të rastit individual, trajtimi dhe vlerësimi mund të përfshijnë trajtimin brenda pacientit (in-Patient) prej disa javësh dhe përfshirjen në një program mbështetës i ndjekur nga kontrole të vazhdueshme, përfshirë këtu testimin e drogës dhe alkoolit dhe raportet që vijnë nga programi mbështetës, i cili mund të kërkohej pafundësisht.



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

konsiderohet. Nëse doza ose lloji i ilaçeve është ndryshuar, kërkohet një periudhë pasuese e vlerësimit të papërshtatshëm deri në konfirmimin e stabilitetit.

(4) Skizofrenia, çrregullimi skizotipal ose delusional

Aplikantët me një historik të vendosur ose diagnozë klinike të skizofrenisë, skizotipale ose çrregullim delirues mund të konsiderohen për një vlerësim të përshtatshëm vetëm nëse vlerësuesi mjekësor i autoritetit liçencues konkludon se diagnoza origjinale ishte e papërshtatshme ose e pasaktë siç konfirmohet nga vlerësimi psikiatrik, ose, në rastin e një episodi të vetëm të deliriumit shkaku i të cilit ishte i qartë, me kusht që aplikanti të mos ketë pësuar dëmtime të përhershme mendore.

(5) Çrregullimi i humorit

Aplikantët me një çrregullim të vendosur të humorit duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Pas shërimit të plotë dhe pas shqyrtimit të plotë të çështjes individuale, një vlerësim i përshtatshëm mund të

(9) Vetë-dëmtimi i qëllimshëm

Aplikantët të cilët kanë kryer një veprim të vetëm ose akte të përsëritura të vetë-shkatërrimit të qëllimshëm ose të vetëvrasjes duhen vlerësuar si të papërshtatshëm. Përpjekja për vetëvrasje duhet të vlerësohet si papërshtatshme. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas shqyrtimit të plotë të një çështjeje individuale dhe mund të kërkojë vlerësime psikiatrike ose psikologjike. Mund të jetë gjithashtu i nevojshëm vlerësimi neuropsikologjik.

(e) Mendimi dhe këshilla e specialistit

(1) Në rast se nevojitet një vlerësim i specialistit, pas vlerësimit, specialisti duhet të paraqesë një raport me shkrim tek AME, AeMC ose vlerësuesi mjekësor i autoritetit liçencues sipas rastit, duke detajuar mendimin dhe rekomandimin etij.

(2) Vlerësimet psikiatrike duhet të bëhen nga një psikiatër i kualifikuar që ka njohuri dhe përvojë adekuate në mjekësinë e aviacionit.



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

konsiderohet, në varësi të karakteristikave dhe ashpërsisë së çrregullimit të humorit.

(6) Çrregullimi neurotik, i lidhur me stresin ose çrregullimi somatoform

Kur ka shenja ose vërtetohen prova që një aplikant mund të ketë një çrregullim neurotik, të lidhur me stresin ose somatoform, aplikanti duhet të drejtohet për mendim dhe këshilla psikiatrike ose psikologjike.

(7) Çrregullimet e personalitetit ose sjelljes

Kur ka shenja ose janë vërtetuar prova që një aplikant mund të ketë çrregullim të personalitetit ose sjelljes, aplikanti duhet të drejtohet për mendim dhe këshilla psikiatrike ose psikologjike.

(8) Çrregullime për shkak të përdorimit ose keqpërdorimit të alkoolit ose substancave të tjera psikoaktive

(i) Aplikantët me çrregullime mendore ose të sjelljes për shkak të alkoolit ose të ndonjë përdorimi ose keqpërdorimi tjetër të substancave psikoaktive, me ose pa varësi, duhet të vlerësohen si jo të përshtatshëm.

(3) Mendimi dhe këshillimi psikologjik duhet të bazohet në një vlerësim klinik psikologjik i kryer nga një psikolog klinik i kualifikuar dhe i akredituar me ekspertizë dhe përvojën e duhur në psikologjinë e aviacionit.

(4) Vlerësimi psikologjik mund të përfshijë një koleksion të të dhënave biografike, administrimin e aftësive, si dhe testet e personalitetit dhe intervistës klinike.



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

(ii) Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas një periudhe dy vjeçare të dokumentuar të të qënurit esëll ose të çlirimit nga përdorimi ose keqpërdorimi i substancave psikoaktive. Për rivlerësimin ose rinovimin, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet më parë me një OML. Në varësi të rastit individual, trajtimi dhe vlerësimi mund të përfshijnë trajtimin brenda pacientit me disa javë dhe përfshirjen në një program mbështetës të ndjekur nga kontrolle të vazhdueshme, përfshirë testimin e drogës dhe alkoolit dhe raportet që vijnë nga programi mbështetës, i cili mund të kërkohej për një periudhë të pacaktuar.

(9) Përpjekja për vetëdëmtim të qëllimshëm dhe për vetëvrasje

Aplikantët të cilët kanë kryer një veprim të vetëm vetë-shkatërrues ose akte të përsëritura të vetëdëmtimit të qëllimshëm ose përpjekje për vetëvrasje duhet të vlerësohen si jo të përshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas shqyrtimit të plotë



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

të një çështjeje individuale dhe mund të kërkojë vlerësimin psikiatrik ose psikologjik. Mund të jetë gjithashtu i nevojshëm vlerësimi neuropsikologjik.

(10) Vlerësimi

Vlerësimi duhet të marrë në konsideratë nëse treguesi për trajtimin, efektet anësore dhe rreziqet e varësisë nga një trajtim i tillë si dhe karakteristikat e çrregullimeve psikiatrike janë në përputhje me sigurinë e fluturimit.

(f) Opinioni dhe këshillat e specialistit

(1) Në rast se nevojitet një vlerësim i një specialisti, pas vlerësimit, specialisti duhet të dorëzojë një raport me shkrim tek AME, AeMC ose tek vlerësuesi aeromjekësor i Autoritetit Liçencues, siç kërkohet duke detajuar opinionin dhe rekomandimin e tyre.

(2) Vlerësimet psikiatrike duhet të bëhen nga një psikiatër i kualifikuar që ka njohuri dhe përvojë adekuate në mjekësinë e aviacionit.

(3) Opinioni psikologjik dhe këshillat psikologjike duhet të bazohen në një vlerësim klinik psikologjik të zhvilluar nga psikologë



Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

	klinikë të akredituar dhe të kualifikuar siç duhet me ekspertizë dhe eksperiencë në psikologjinë e aviacionit. (4) Vlerësimi psikologjik mund të përfshijë një koleksion me të dhëna biografike, administrimin e aftësive si edhe teste të personalitetit dhe intervista klinike.	
MED.B.060 Psikologjia a)Aplikantët nuk duhet të kenë mangësi të caktuara psikologjike, të cilat mund të ndërhyjnë në ushtrimin e sigurtë të privilegjeve të liçencës së përdorur. b)Një vlerësim psikologjik do të kërkohet si pjesë plotësuese e ekzaminimit nga një specialist psikiatrik ose neurologjik .		
MED.B.065 Neurologjia (a) Aplikantët me diagnozë klinike ose historik mjekësor të dokumentuar të një prej gjendjeve mjekësore të mëposhtme klasifikohen si të papërshtatshëm : (1) epilepsi, me përjashtim të rasteve të	AMC1 MED.B.065 Neurologjia (A) Epilepsia (1) Diagnostifikimi i epilepsisë është skualifikues (i papërshtatshëm), përveç rasteve kur ekziston dëshmi e qartë e një sindromi të epilepsisë beninje të fëmijërisë që shoqërohet	AMC2 MED.B.065 Neurologjia (A) Epilepsia Një aplikant mund të vlerësohet i përshtatshëm nëse: (1) ka një historik të krizave epileptiforme afebrile, që konsiderohet të ketë një rrezik

Data e lëshimit: 24/10/2019

Rishikimi Nr: 00

Faqe: 96 nga 158



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

përmendura në pikat (1) dhe (2) të pikës (b); (2) episode të përsëritura të çrregullimeve të ndërgjegjes për shkaqe të pasigurta; (b) Aplikantët me diagnozë klinike ose me historik mjekësor të dokumentuar të një prej kushteve mjekësore të mëposhtme, i nënshtrohen vlerësimeve të mëtejshme para se të klasifikohen për përshtatshmërinë mjekësore (1) epilepsi pa përsëritje pas moshës 5 vjeç; (2) epilepsi pa përsëritje dhe pa trajtime për më shumë se 10 vjet; (3) anomali të formës epilektike WG dhe valë fokale të ngadalta; (4) sëmundje progresive dhe jo progresive të sistemit nervor; (5) sëmundje inflamatore të sistemit nervor qendror ose periferik; (6) migrena; (7) episod i vetëm të çrregullimeve të ndërgjegjes për shkaqe të pasigurta; (8) humbje e ndërgjegjes pas lëndimit në kokë;	me një rrezik shumë të ulët të përsëritjes dhe nëse aplikanti nuk ka pasur përsëritje dhe ka qendruar jashtë trajtimit për më shumë se 10 vjet. Një ose më shumë episode konvulsive pas moshës 5 vjeçare janë skualifikuese. Në rastin e një krize akute simptomatike, që konsiderohet të ketë një rrezik shumë të ulët të përsëritjes, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas rishikimit neurologjik. (2) Një aplikant mund të vlerësohet si i përshtatshëm nga autoriteti licencues me një kufizim OML nëse: (i) ka një histori të një krize epileptiforme të vetme afebrile; (ii) nuk ka pasur përsëritje pas trajtimit të paktën 10 vjet pas trajtimit; (iii) nuk ka dëshmi të predispozimit të vazhdueshëm ndaj epilepsisë. (c) EEG (1) Elektroencefalografia (EEG) kërkohet kur ndikohet nga historia e aplikuesit ose në baza	shumë të ulët të përsëritjes; (2) nuk ka pasur përsëritje pas të paktën 10 vjet jashtë mjekimit; (3) nuk ka dëshmi për kriza të vazhdueshme të epilepsisë. (b) Kushtet me prirje të lartë për mosfunksionim cerebral Një aplikant me një kusht me prirje të lartë për mosfunksionim cerebral duhet të vlerësohet si i papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas vlerësimit të plotë. (b) Sëmundjet neurologjike Çdo sëmundje stacionare ose progresive e sistemit nervor që ka shkaktuar ose ka të ngjarë të shkaktojë një paaftësi të konsiderueshme është skualifikuese. Në rast të humbjes së vogël funksionale të shoqëruar me sëmundje stacionare, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas vlerësimit të plotë, i cili duhet të përfshijë një test mjekësor fluturimi që mund të zhvillohet edhe në simulator fluturues. (c) Migrena
--	---	---



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

(9) lëndim për shkak të penetrimit në tru;
(10) lëndim nervor kurrizor ose periferik;
(11) çrregullime të sistemit nervor për shkak të defekteve vaskulare, duke përfshirë rastet e hemoragjisë dhe ishemisë.

Aplikantët për çertifikatë mjekësore të klasës 1 i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçensues. Aftësia për punë e aplikantëve që aplikojnë për një çertifikatë mjekësore të klasës 2 vlerësohen duke u konsultuar me vlerësuesin mjekësor të autoritetit liçencues.

klinike.

(2) Anomalitë e valëve epileptiformeve paroksizmale në EEG dhe valët e ngadalta fokale duhet të jenë skualifikuese (Aplikant i papërshtatshëm).

(d) Sëmundjet neurologjike

Çdo sëmundje stacionare ose progresive e sistemit nervor që ka shkaktuar ose ka të ngjarë të shkaktojë një paaftësi të konsiderueshme është skualifikuese (Aplikant i papërshtatshëm). Megjithatë, në rast të humbjeve të vogla funksionale të lidhura me sëmundjen stacionare, një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas vlerësimit të plotë, i cili duhet të përfshijë një test mjekësor fluturimi i cili mund të zhvillohet në një simulator fluturimi.

(e) Episodi i shqetësimit (humbjes) të ndërgjegjjes

Në rastin e një episodi të vetëm të shqetësimit (humbjes) të vetëdijes, i cili mund të shpjegohet në mënyrë të kënaqshme, mund të konsiderohet një vlerësim i përshtatshëm, por

Aplikantët me një diagnozë të vendosur të migrenës ose dhimbje koke të tjera periodike të mundshme që shkaktojnë rrezik për sigurinë e fluturimit duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet pas vlerësimit të plotë. Vlerësimi duhet të marrë parasysh të paktën sa vijon:

aurat, humbjen e fushës vizuale, shpeshtësinë, ashpërsinë dhe terapinë. Mund të zbatohen kufizime (et) e përshtatshme.

(d) Dëmtimi i kokës

Një aplikues me një dëmtim në kokë i cili ka qënë mjaft i ashpër për të shkaktuar humbje të ndërgjegjjes ose që shoqërohet me penetrim të dëmtimit të trurit, mund të vlerësohet i përshtatshëm nëse ka pasur një shërim të plotë dhe rreziku i epilepsisë është mjaft i ulët. Mund të kërkohej një vlerësim nga një neurolog në varësi të stadi të dëmtimit origjinal.

(e) Dëmtimi i nervit kurrizor ose periferik
Aplikantët me një historik ose diagnozë të



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

një përsëritje duhet të diskualifikohet (aplikanti i papërshtatshëm).

(f) Dëmtimi i kokës

Një aplikues me një dëmtim në kokë, i cili ishte mjaft i rëndë për të shkaktuar humbje të ndërgjegjjes ose që shoqërohet me lëndimin e trurit ose me penetrim, duhet të shqyrtohet nga një neurolog ose konsulent. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse ka pasur shërim të plotë dhe rreziku i epilepsisë është mjaft i ulët.

(g) Dëmtimi i shtyllës kurrizore ose nervave periferike, miopati. Një aplikues me një histori ose diagnozë të dëmtimit të shtyllës kurrizore ose nervave periferik ose miopati duhet të vlerësohet si i papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse rikontrollet neurologjike dhe vlerësimet muskuloskeletale janë të kënaqshme dhe kushtet në AMC1 MED.B.050, janë përmbushur.

(h) Mangësitë vaskulare

Aplikantët me një çrregullim të sistemit nervor

dëmtimit të nervit kurrizor ose periferik ose një çrregullim të sistemi nervor për shkak të një dëmtimi traumatik duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse vlerësimi neurologjik është i kënaqshëm dhe kushtet e AMC2 MED.B.050 janë përmbushur.

(f) Mangësitë vaskulare

Aplikantët me një çrregullim të sistemit nervor për shkak të mangësive vaskulare përfshirë ngjarjet hemorragjike dhe ishemike duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse vlerësimi neurologjik është i kënaqshëm dhe dispozitat e AMC2 MED.B.050 janë përmbushur. Një vlerësim kardiologjik dhe një test mjekësor fluturimi duhet të bëhet për aplikantët me mangësi të mbetura.



Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

	për shkak të mangësive vaskulare përfshirë ngjarjet hemorragjike dhe ishemike duhet të vlerësohen si të papërshtatshëm. Një vlerësim i përshtatshëm mund të konsiderohet nëse vlerësimi neurologjik është i kënaqshëm dhe kushtet e AMC1 MED.B.050 janë përmbushur. Për aplikantët me mangësi të mbetura duhet të bëhet një vlerësim kardiologjik dhe një test fluturimi mjekësor.	
MED.B.070 Sistemi i shikimit (a) Ekzaminimi (1) Për çertifikatat mjekësore të klasës 1: (i) ekzaminimi gjithëpërfshirës i syrit është pjesë e ekzaminimit fillestar dhe kryhet kur kërkohet klinikisht dhe në mënyrë periodike, në varësi të numrit dhe performancës funksionale të syrit. (ii) ekzaminimi rutinë i syrit është pjesë e të gjitha ekzaminimeve të rivlerësimit dhe rinovimit. (2) Për çertifikatat mjekësore të klasës 2: (i) ekzaminimi rutinë i syrit është pjesë e të gjitha ekzaminimeve fillestare të rivlerësimit	AMC1 MED.B.070 Sistemi pamor (a) Ekzaminimi i syrit (1) Në secilin ekzaminim aero-mjekësor të rivlerësimit, duhet të kryhet një vlerësim i përshtatshmërisë vizive dhe sytë duhet të shqyrtohen në lidhje me patologjitë e mundshme. (2) Të gjitha rastet anormale dhe të dyshimta duhet t'i referohen një oftalmologu. Kushtet që tregojnë ekzaminimin oftalmologjik përfshijnë, por nuk kufizohen në, një rënie të konsiderueshme në mprehtësinë e pamerituar, çdo rënie në mprehtësinë vizive më të mirë të korrigjuar dhe / ose ndonjë sëmundje të syrit,	AMC2 MED.B.070 Sistemi pamor (a) Ekzaminimi i syrit (1) Në secilin ekzaminim të ri-vlerësimit aero-mjekësor duhet të kryhet një vlerësim i përshtatshmërisë vizive të mbajtësit të liçencës dhe sytë duhet të shqyrtohen në lidhje me patologjitë e mundshme. Kushtet që kërkojnë ekzaminim të mëtejshëm oftalmologjik përfshijnë, por nuk kufizohen në, një rënie të theksuar të mprehtësisë pamore, ndonjë ulje në mprehtësinë më të mirë të korrigjuar vizive dhe/ose sëmundje të syrit, dëmtim të syrit ose kirurgjisë së syrit. (2) Në vlerësimin fillestar, ekzaminimi duhet të

Data e lëshimit: 24/10/2019

Rishikimi Nr: 00

Faqe: 100 nga 158



Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

dhe rinovimit.

(ii) ekzaminimi gjithëpërfshirës i syrit ndërmerret kur kërkohet klinikisht.

(b) Mprehtësia e shikimit

(1) Për çertifikatat mjekësore të klasës 1:

(i) Mprehtësia e shikimit në distancë, me ose pa korrigjim, duhet të jetë 6/9 (0,7) ose më e mirë në secilin sy veçmas dhe mprehtësia e shikimit me të dy sytë duhet të jetë 6/6 (1,0) ose më e mirë.

(ii) Në ekzaminimin fillestar, aplikantët me nivel të ulët shikimi në një sy klasifikohen si të papërshtashëm.

(iii) Në ekzaminimin e rivlerësimit dhe rinovimit, pavarësisht pikës (b)(1)(i), aplikantët me nivel shikimi të fituar nën standard në një sy ose me monokularitet të fituar i referohen vlerësuesit mjekësor të autoritetit liçencues dhe mund të klasifikohen të papërshtashëm, në bazë të një vlerësimi të imtësishëm oftalmologjik.

(2) Për çertifikatat mjekësore të klasës 2:

(i) Mprehtësia e shikimit në distancë, me ose

dëmtimit të syve ose kirurgjisë së syrit.

(3) Kur kërkohet vizitë e specializuar oftalmologjike për ndonjë arsye të rëndësishme, kjo duhet të vendoset si një kufizim në çertifikatën mjekësore.

(b) Ekzaminimi gjithëpërfshirës i syve

Një vizitë gjithëpërfshirëse e syrit nga një specialist i syrit kërkohet në ekzaminimin fillestar. Të gjitha rastet anormale dhe të dyshimta duhet t'i referohen një oftalmologu. Ekzaminimi duhet të përfshijë:

(1) historikun;

(2) mprehtësinë vizive – shikimin e afërt, të ndërmjetm dhe të largët (korrigjuar ose jo dhe me korrigjimin më të mirë nëse është e nevojshme);

(3) ekzaminimin e syrit të jashtëm, anatomisë, mediave (dhoma e ndarjes) dhe fundoskopisë;

(4) motilitetin okular;

(5) pamjen binokulare;

(6) pamjen me ngjyra;

(7) fushën vizive (pamjes);

(8) tonometrinë mbi indikacionin klinik;

përfshijë:

(i) historikun;

(ii) mprehtësinë vizive - shikimin e afërt, të ndërmjetm dhe të largët (korrigjuar ose jo dhe me korrigjimin optik nëse është e nevojshme);

(iii) ekzaminimin e syrit të jashtëm, anatomisë, mediave dhe fundoskopisë;

(iv) lëvizshmërinë e syrit;

(v) pamjen binokulare;

(vi) pamjen me ngjyra dhe fushën pamore;

(vii) ekzaminimin e mëtejshëm mbi indikacionin klinik.

(3) Në vlerësimin fillestar, aplikanti duhet të paraqesë një kopje të recetës së fundit të syzeve nëse kërkohet korrigjimi pamor për të plotësuar kërkesat vizive.

(b) Ekzaminimi rutinë i syve.

Një ekzaminim rutinë i syrit duhet të përfshijë:

(1) historikun;

(2) mprehtësinë pamore - shikimin e afërt, të ndërmjetm dhe të largët (jo e korrigjuar dhe me korrigjimin më të mirë optik nëse është e



**Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet
aero-mjekësore të ekuipazhit ajror**

Zotëruesi

AAC

Dokumenti

O3-3.MU/PT.001

MED.C.035 Kufizimet (a) Nëse mbajtësit e një dëshmie të ekuipazhit të kabinës nuk përputhen plotësisht me kërkesat e specifikuara në Seksionin 2, AME AeMC ose OHMP do të merret në konsideratë nëse ata mund të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e ekuipazhit të kabinës në mënyrë të sigurtë, nëse veprojnë në përputhje me një ose më shumë kufizime. (b) Çdo kufizim për ushtrimin e privilegjeve të dhëna nga dëshmia e ekuipazhit të kabinës do të specifikohet në raportin mjekësor të ekuipazhit të kabinës dhe do të hiqet vetëm nga një AeMC, AME ose nga një OHMP në konsultim me një AME.	AMC1 MED.C.035 Kufizimet Kur vlerësohet nëse mbajtësi i një liçence të ekuipazhit të kabinës mund të jetë në gjendje të kryejë detyrat e ekuipazhit të kabinës në mënyrë të sigurt, duhet të merren parasysh kufizimet e mundshme të mëposhtme: (a) një kufizim për të vepruar vetëm në operacionet në kabinë me shumë ekuipazh (MCL); (b) një kufizim ndaj tipit të avionëve të specifikuar (OAL) ose një tipi të specifikuar të operimit (OOL); (c) një kërkesë për t'iu nënshtruar ekzaminimit të ardhshëm aero-mjekësor dhe / ose vlerësimit në një datë më të hershme sesa kërkohet nga MED.C.005 (b) (TML); (d) një kërkesë për t'iu nënshtruar ekzaminimeve të rregullta mjekësore (SIC); (e) një kërkesë për korrigjim vizual (CVL), ose vetëm me anë të lenteve korrigjuese (CCL); (f) një kërkesë për përdorimin e aparateve të dëgjimit (HAL); dhe (g) kufizime të veçanta siç specifikohet (SSL).

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

7.4. Aneksi IV: MJEKIMI - UDHËZUES PËR PILOTËT DHE EKUIPAZHIN E KABINËS

- a) Çdo mjekim mund të ketë efekte anësore, disa prej të cilave mund të dëmtojnë sigurinë dhe performancën gjatë fluturimit. Ndërkohë, simptomat e të ftohtit, djegia e fytit, diarrea dhe çrregullime të tjera në bark, mund të shkaktojnë pak ose aspak probleme në tokë, por mund të shpërqëndrojnë pilotin ose personelin e kabinës dhe të dëmtojnë performancën gjatë punës. Edhe mjedisi gjatë fluturimit mund të rrisë ashpërsinë e simptomave, ndërkohë që në tokë këto simptoma mund të jenë minimale. Prandaj një problem gjatë mjekimit dhe fluturimit, është situata shëndetësore, si dhe mbivendosja e efekteve anësore të mjekimit të rekomanduar dhe/ose të blerë pa recetë për trajtimin e problemit shëndetësor. Ky material udhëzues u ofron ndihmë pilotëve dhe stafit të kabinës për të vendosur kur duhet të kërkojnë ndihmë nga eksperti AME, AeMC, Mjeku i Përgjithshëm apo Vlerësuesi Mjekësor sipas rregullores.
- b) Përpara fillimit të çdo mjekimi dhe punës si pilot apo personel kabine, tre pyetjet e mëposhtme bazike duhet të kenë përgjigje të kënaqshme.
- 1) Ndihej mirë të fluturoj?
 - 2) Kam vërtetë nevojë të marr mjekim?
 - 3) I kam dhënë kohën e mjaftueshme këtij mjekimi specifik në tokë, për të qënë i sigurt që nuk do të kem efekte të padëshiruara në aftësitë e mia për të fluturuar?
- c) Konfirmimi i mungesës së efekteve të padëshiruara kërkon këshillën e një eksperti.
- d) Më poshtë janë disa mjekime të përdorura gjërësisht me një përshkrim të kompatibilitetit të tyre me detyrën në fluturim:
- (1) Antibiotikët. Penicilina të ndryshme, tetraciklina, makrolidet, frenuesit e enzimes giraze dhe të tjerë, mund të kenë efekte anësore afat-shkurtra, ose të vonuara, të cilët mund të dëmtojnë performancën e pilotit ose personelit të kabinës. Në mënyrë të konsiderueshme, përdorimi i tyre tregon për praninë e një infeksioni, dhe në këtë mënyrë efektet e këtij infeksioni nënkuptojnë që piloti ose personeli i kabinës nuk është i aftë të fluturojë dhe i duhet të kërkojë këshillën e ekspertit aero-mjekësor.
- (2) Medikamentet anti-malarike. Vendimi për nevojën e përdorimit të preparateve anti-malarike varet nga zona që do të vizitohet dhe nga rreziku që piloti apo personeli i kabinës ekspozohen ndaj mushkonjave dhe shfaqin malarjen. Një këshillë mjekësore eksperti duhet të merret, në kuptimin që a duhen marrë preparate anti-malarike dhe të çfarë lloji duhen përdorur. Shumica e ilaçeve anti-malarike (atovaguon plus proguanil, klorokuina, doksiciklina) janë kompatibël me detyrat e fluturimit. Megjithatë efektet e padëshiruara të lidhura me

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 154 nga 158
-----------------------------	------------------	-------------------

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

përdorimin e Meflokuinës përfshijnë: pagjumësinë, endrra të çuditshme, ndryshim të humorit, nauze, diarre dhe dhimbje koke. Por Meflokuina mund të shkaktojë dhe dizorientim në hapësirë, mungesë të koordinimeve të imta, dhe si rrjedhojë nuk është kompatibël me detyrat e fluturimit.

(3) Antihistaminikët. Antihistaminikët mund të shkaktojnë përgjumje. Ata përdoren gjerësisht në “kurat e të ftohtit” dhe në trajtimin e “etheve të kashtës”, asmës dhe rashet alergjike. Mund të jenë si tableta, ose pika apo spraj për hundë. Në shumë raste vetë gjëndja shëndetësore mund të pengojë fluturimin, kështu që, n.q.s trajtimi është i nevojshëm, këshilla e ekspertit aero-mjekësor duhet kërkuar, me qëllim që të ashtu quajturat antihistaminat josedative, të mund të rekomandohen për të mos dëmtuar performancën njerëzore.

(4) Mjekimet për kollën. Antitusivët shpesh përmbajnë kodeinë, dekstrometorfane ose pseudo-efedrinë, të cilët janë të papajtueshëm me detyrat e fluturimit. Megjithatë agentet mukolitike (psh. karbocisteina) tolerohen mirë dhe janë kompatibël me detyrat e fluturimit.

(5) Dekongjestionantët. Dekongjestionantët e hundës pa efekte në vigjilencë (psh. klobutinol ose okseladin) janë kompatibël me detyrat e fluturimit. Megjithatë, shpesh edema e membranës mukozale shkakton vështirësi në barazimin e presioneve në vesh ose sinuse dhe kështu e bën pilotin dhe personelin e fluturimit të paafhtë për detyrat e fluturimit.

(6) Kortikosteroidet e hundës përdoren shpesh për të trajtuar “ethet e kashtës”, dhe janë kompatibël me detyrat e fluturimit.

(7) Qetësuesit e dhimbjeve, anti-febrilet dhe kundër dhimbjeve të kokës. Anti-inflamatorët josteroide përdoren shpesh për të trajtuar dhimbjen, temperaturën dhe dhimbjen e kokës, mund të jenë kompatibël me detyrat e fluturimit (paracetamol, aspirin, ibuprofen). Megjithatë, piloti ose personeli i kabinës duhet t’u ketë dhënë përgjigje pozitive tre pyetjeve bazike përpara përdorimit të mjekimit dhe fluturimit.

(8) Anti-ulcerozët (Antacidet). Frenuesit e sekrecioneve gastrike siç janë H2 antagonistët (psh. ranitidine, cimetidine) ose frenuesit e pompës protonike (psh. omeprazole) mund të pranohen pas diagnostikimit të sëmundjes. Është e rëndësishme të kërkohet diagnoza mjekësore dhe jo të trajtohen vetëm simptomat dispeptike.

(9) Medikamentet anti-diarreike. Loperamidi është anti-diarreiku më i përdorshëm dhe është i sigurt në përdorimin e tij në fluturim. Megjithatë, diarreja në vetvete shpesh i bën pilotët dhe stafin e fluturimit të paafhtë për të fluturuar.

(10) Kontracepsioni hormonal dhe terapia hormonale zëvendësuese zakonisht nuk kanë efekte të padëshiruara dhe janë kompatibël me fluturimin dhe detyrat e sigurisë në kabinë.

 AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

(11) Mjekimi për çrregullimet erectile. Ky mjekim mund të shkaktojë çrregullime në pamjen e ngjyrave dhe marrje mendsh. Duhet të paktën 24 orë ndërmjet marrjes së mjekimit dhe detyrave në fluturim.

(12) Lënia e duhanit. Terapia zëvendësuese me nikotinë mund të lejohet. Megjithatë, mjekimet e tjera që prekin sistemin nervor qendror (bupropion, varenikline) nuk janë të pranueshme për pilotët.

(13) Mjekimi për tensionin e lartë të gjakut. Barnat anti-hipertensive janë kompatibël me fluturimin vetëm pasi të bëhet konsultimi me AME, AeMC, Mjekun e Përgjithshëm, Mjekun e Punës ose Vlerësuesin Mjekësor sipas rregullave të zbatueshme. Disa prej këtyre barnave mund të shkaktojnë ndryshime në refleksat kardivaskulare normale dhe të prekin performancën intelektuale, e cila dëmton seriozisht sigurinë e fluturimit. N.q.s tensioni i gjakut është në nivele që duhet trajtuar, piloti përkohësisht nuk duhet të fluturojë dhe duhet të monitorohet për ndonjë efekt anësor. Ndonjë trajtim i dhënë duhet diskutuar me AME, AeMC, Mjekun e Përgjithshëm, Mjekun e Punës ose Vlerësuesin Mjekësor sipas rregullave të zbatueshme (Shih MED.B.010(j)).

(14) Mjekimi i astmës. Astma duhet të jetë klinikisht stabël përpara se piloti apo personeli i kabinës të mund të kthehet në detyrat e fluturimit. Përdorimi i aerosoleve respiratore, si psh. kortikosteroidet, beta-2-agonistët, acidi kromoglicik apo barnat anti-kolinergjike në doza të ulta mund të jenë kompatibël me detyrat e fluturimit. Megjithatë, përdorimi oral i steroideve ose derivateve të teofilinës, është i papajtueshëm me detyrat e fluturimit. N.q.s një pilot ose personel kabine përdor ndonjë mjekim për astmën, ai/ajo duhet të konsultohet me AME, AeMC, Mjekun e Përgjithshëm, Mjekun e Punës ose Vlerësuesin Mjekësor sipas rregullave të zbatueshme (Shih MED.B.015(c)).

(15) Analgjezikët. Analgjezikët më të fuqishëm janë derivate të opiateve dhe mund të shkaktojnë një ulje të madhe të performancës njerëzore. N.q.s duhen përdorur këta analgjezikë, dhimbja për të cilën ata merren, zakonisht tregon një kusht mjekësor i cili pengon detyrat e fluturimit.

(16) Qetësuesit anti-depresivët dhe sedativët. Pamundësia për të reaguar, si pasojë e përdorimit të këtyre barnave, ka qënë një faktor shtesë në aksidentet ajrore fatale. Në vazhdimësi, kushti mjekësor për të cilin këto mjekime janë dhënë, me siguri nënkupton që gjëndja mendore e pilotit ose personelit të kabinës nuk është kompatibël me detyrat e fluturimit (shih MED.B.050).

(17) Tabletat për gjumë. Tabletat e gjumit dëmtojnë shqisat dhe ndijimet, mund të shkaktojnë konfuzion mendor dhe reagim të ngadaltë. Kohëzgjatja e efekteve ndryshon dhe varion nga individi tek individi dhe mund të zgjatet për një kohë të papërcaktuar. Ky mjekim duhet evituar

Data e lëshimit: 24/10/2019	Rishikimi Nr: 00	Faqe: 156 nga 158
-----------------------------	------------------	-------------------

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

të paktën një natë përpara detyrës dhe një këshillë nga eksperti aero-mjekësor duhet kërkuar përpara përdorimit.

(18) Melatonin. Melatonin është një hormon që përfshihet në rregullimin e ritmit cirkadian. Në disa shtete është një medikament që jepet vetëm me recetë, ndërsa në shumë të tjerë konsiderohet një “suplement dietetik” dhe mund të blihet edhe pa recetë. Rezultatet e efikasitetit të melatoninës në trajtimin e “jet lag” apo çrregullimeve të gjumit, kanë qënë kontradiktore. Megjithatë, melatonina shkakton përgjumje, dhe duhet evituar të paktën një natë përpara fluturimit. Përdorimi i melatoninës duhet bërë në konsultim me AME, AeMC ose Këshilluesin Mjekësor sipas rregullave.

(19) Stimulantët, kafeina, amfetamina etj.. (të njohura si “tabletat pep”) përdoren për të ndenjur zgjuar ose frenuar oreksin, janë shpesh zakon formuese. Ndjeshmëria ndaj stimulantëve të ndryshëm ndryshon nga individ në individ, dhe tek të gjithë mund të shkaktojë një mbivlerësim të rrezikshëm të vetvetes. Mbidozimi shkakton dhimbje koke, marrje mendsh dhe çrregullime mendore. Përdorimi i “tabletave pep” nuk lejohet në fluturim. Kur marrja e kafesë nuk ofron një stimulim të mjaftueshëm, atëherë ky individ nuk është i aftë për fluturim. Duhet mbajtur mend se pirja e tepruar e kafesë, ka efekte të dëmshme përfshi çrregullime të ritmit të zemrës (shih MED.B.055(b)).

(20) Anestezikët. Pas një anestezie lokale, të përgjithshme, dentare apo anestezie të tjera, duhet të kalojë një periudhë kohe përpara kthimit në fluturim. Kjo kohë ndryshon nga individ në individ, por një pilot ose personel kabine nuk duhet të fluturojë të paktën 12 ore pas një anestezie lokale, dhe për të paktën 48 orë pas një anestezie të përgjithshme, spinale apo epidurale (Shih MED.A.020).

(e) Shumë preparate në treg në ditët e sotme janë një kombinim medikamentesh. Prandaj është e domosdoshme që n.q.s është një mjekim i ri apo dozimi ri, sado i vogël, efektet duhet të vëzhgohen nga piloti apo personeli i kabinës në tokë, përpara se të fluturojë. Duhet theksuar që mjekimi, i cili normalisht nuk ndikon në performancën e pilotit apo personelit të kabinës, mund të ndikojë tek individë të tjerë që janë “të mbindjeshëm” ndaj një preparati specifik. Individët këshillohen të mos marrin ndonjë mjekim ndërkohë që duhet të fluturojnë, vetëm n.q.s janë plotësisht të familjarizuar me efektet në trupin e tyre. Në kushte dyshimi, piloti ose personeli i kabinës duhet të konsultohet me AME, AeMC, Mjekun e Përgjithshëm, Mjekun e Punës, ose Këshilluesin Mjekësor sipas rregullave të zbatueshme.

	Manual Udhëzues për çertifikimin e AME-ve dhe çertifikimet aero-mjekësore të ekuipazhit ajror	
	Zotëruesi	AAC
	Dokumenti	O3-3.MU/PT.001

(f) Trajtime të tjera

Mjekësia alternative apo plotësuese si: akupunktura, homepatia, terapia hipnotizuese dhe disa disiplina të tjera, janë duke u zhvilluar dhe po fitojnë besueshmëri më të madhe. Trajtime të tilla janë më të pranueshme në disa shtete sesa të tjerat. Është e nevojshme të sigurohemi që “trajtimet e tjera”, si dhe kushtet shëndetësore bazë, të deklarohen dhe të merren në konsideratë nga AME, AeMC, Mjeku i Përgjithshëm, Mjeku i Punës, ose Këshilluesi Mjekësor sipas rregullave të zbatueshme kur vlerëson aftësitë e pilotit apo ekuipazhit të kabinës.



AAC/ACAA
FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË
AVIACIONIT CIVIL
APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE



Forma e RSH-së sipas EASA MED 160

03-3.FMU/PT.001.FRM.001

FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË AVIACIONIT CIVIL
APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE

COMPLETE THIS PAGE FULLY AND IN BLOCK CAPITALS – REFER TO INSTRUCTIONS PAGES FOR DETAILS

PLOTËSONI KËTË FAQE PLOTËSISHT DHE ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT-REFEROJUNI FLETËVE INSTRUKTUESE PËR DETAJE

PLOTËSONI KËTË FLETË TËRËSISHT DHE ME SHKRONJA TË MËDHA TË SHTYPIT-REFEROJUNI INSTRUKSIONEVE PËR PLOTËSIMIN

COMPLETE THIS PAGE FULLY AND IN BLOCK CAPITALS – REFER TO INSTRUCTIONS FOR COMPLETION

Medical in Confidence/ Mjekësore në konfidencë

(3) Mbiemri: <i>Surname</i>		(4) Mbiemri i mëparshëm: <i>Previous surname(s)</i>		Titulli: <i>Title</i>		(13) Numri i referencës AAC <i>ACAA Reference number:</i> AL:	
(5) Emri: <i>Forenames</i>		(6) Ditëlindja: <i>Date of birth</i>		(7) Gjinia/Sex:		(12) Aplikim/ <i>Application</i> Fillestar/ <i>Initial</i> ☐ Rivalidim/ <i>Revalidation</i> ☐ Rinovim/ <i>Renewal</i> ☐	
(1) Shteti lëshues i liçencës: <i>State of licence issue</i>		(2) Çertifikata mjekësore për të cilën aplikohet: 1 ☐ 2 ☐ LAPL ☐ <i>Medical certificate applied for:</i>				(14) Tipi i liçencës së kërkuar : <i>Type of licence applied for:</i>	
(8) Vendi dhe shteti i lindjes <i>Place and country of birth:</i>		(9) Kombësia <i>Nationality:</i>		(15) Punësimi (kryesor) <i>Occupation (principal)</i>			
(10) Adresa e përhershme: <i>Permanent address:</i> Tel: Email:		(11) Adresa postare (nëse është e ndryshme) <i>Postal address (if different)</i> Tel: Email:		(16) Punëdhënësi/Employer: (17) Ekzaminimi i fundit mjekësor/ <i>Last medical examination</i> <i>Data/Date:</i> <i>Vëndi/Place:</i>			
				(18) Liçenca e mbajtur (tipi): <i>Aviation licence(s) held (type):</i> <i>Numri i liçencës/Licence number:</i> <i>Shteti i lëshimit/State of issue:</i>			
(500) Emri i GP/ <i>GP Name:</i> <i>Adresa / Address:</i> <i>Numri i telefonit/ Telephone Number:</i>		(19) Çdo limitim në Liçencë/Çertifikatë mjekësore të mbajtur PO ☐ Jo ☐ <i>Any limitations on licence(s)/medical certificate held</i> Yes ☐ No ☐ <i>Detaje:</i> <i>Details:</i>					
(20) A ju është mohuar, pezulluar, apo anuluar ndonjëherë çertifikata mjekësore e aviacionit nga ndonjë autoritet liçencues? Nëse po, diskutoni me AME <i>Have you ever had an aviation medical certificate denied, suspended or revoked by any licensing authority? If yes, discuss with AME</i> Jo/No ☐ Po/Yes ☐ <i>Data/Date:</i> <i>Vëndi/Place:</i> <i>Detaje/Details:</i>							
(21) Totali i kohës së fluturimit: <i>Flight time total:</i>		(22) Koha e fluturimit që nga mjekësori i fundit: <i>Flight time since last medical:</i>		(23) Tipi/Klasa e avionit që fluturohet aktualisht: <i>Aircraft Class /Type(s) presently flown:</i>			
(24) Ndonjë aksident ose incident ajror të raportuar që nga mjekësori i fundit? <i>Any aviation accident or reported incident since last medical examination?</i> Jo/No ☐ Po/Yes ☐ <i>Data/Date:</i> <i>Vëndi/Place:</i> <i>Detaje/Details:</i>				(25) Tipi i synuar i fluturimit: <i>Type of flying intended:</i>			
				(26) Aktiviteti aktual i fluturimit/ <i>Present flying activity:</i> Me një pilot/ <i>Single pilot</i> ☐ Multi – pilot/ <i>Multi pilot</i> ☐			



AAC/ACAA
FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË
AVIACIONIT CIVIL
APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE



Forma e RSH-së sipas EASA MED 160

03-3.FMU/PT.001.FRM.001

(27) Alkooli-deklaroni pirjen javore mestare në njësi <i>Alcohol – state average weekly intake in units:</i>	
(29) A pini duhan? / Do you smoke tobacco? Deklaroni tipin, sasinë dhe numrin e viteve: <i>State type, amount & number of years:</i>	Kurrë/Never ☐ Jo/No ☐ Po/Yes ☐ Data kur e keni lënë/Date stopped:

(28) A përdorni ndonjë ilaç, aktualisht? / Do you currently use any medication? Jo/No ☐ Po/Yes ☐ Nëse po, deklaroni mjekimin, dozën, datën e fillimit dhe arsyen <i>If YES, state medication, dose, date started and why</i>
--

--	--	--

(3) Mbiemri: <i>Surname</i>	(4) Mbiemri i mëparshëm : <i>Previous surname(s)</i>	Titulli: <i>Title</i>	(13) Numri i referencës AAC/ ACAA Reference number: AL:
--------------------------------	---	--------------------------	--

Historik i përgjithshëm dhe mjekësor: A keni apo keni pasur ndonjëherë ndonjë nga të renditurat më poshtë? (Ju lutem shënoni). Nëse po, jepni detaje në seksionin e shënimeve (30).

General and medical history: Do you have, or have you ever had, any of the following? (Please tick). If yes, give details in remarks section (30).

Po/Yes	Jo/No	Po/Yes	Jo/No	Po/Yes	Jo/No	Po/Yes	Jo/No
101 Shqetësime të syve/ operacion të syve <i>Eye trouble/eye operation</i>		112 Çrregullime të hundës, fytit, të të folurit <i>Nose, throat or speech disorder</i>		123 Malaria/ose sëmundje tjetër tropikale <i>Malaria or other tropical disease</i>		Vetëm Femrat/Females only:	
102 Syzet dhe / ose lentet e kontaktit të vendosura ndonjëherë <i>Spectacles and/or contact lenses ever worn</i>		113 Përplasje apo dëmtim në kokë <i>Head injury or concussion</i>		124 HIV test pozitiv <i>A positive HIV test</i>		150 Probleme gjinekologjike, menstruale <i>Gynaecological, menstrual problems</i>	
103 Ndryshimi i recetave të syzeve/ lenteve të kontaktit / që nga ekzaminimi i fundit mjekësor. <i>Spectacle/contact lens prescriptions/change since last medical exam</i>		114 Dhimbje koke të forta/të shpeshta <i>Frequent or severe headaches</i>		125 Sëmundje seksualisht të transmetuara <i>Sexually transmitted disease</i>		151 A jeni shtatzënë? <i>Are you pregnant?</i>	
104 Ethet Hey, alergji të tjera <i>Hay fever, other allergy</i>		115 Marrje mendësh apo të fikët <i>Dizziness or fainting spells</i>		126 Shtrim në spital <i>Admission to hospital</i>		Historiku Familjar/ Family history of:	
105 Astma, sëmundje të mushkërive <i>Asthma, lung disease</i>		116 Humbje ndjenjash për çfarëdo arsye <i>Unconsciousness for any reason</i>		127 Çdo sëmundje ose lëndim tjetër <i>Any other illness or injury</i>		170 Sëmundje të zemrës <i>Heart disease</i>	
106 Probleme të zemrës ose vaskulare <i>Heart or vascular trouble</i>		117 Çrregullime neurologjike; ictus, epilepsi, konvulsione, paralizë, etj. <i>Neurological disorders; stroke, epilepsy, seizure, paralysis, etc</i>		128 Vizita në mjekë të përgjithshëm që nga mjekimi i fundit <i>Visit to medical practitioner since last medical examination</i>		171 Presion i lartë i gjakut <i>High blood pressure</i>	



AAC/ACAA

FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË AVIACIONIT CIVIL

APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE



Forma e RSH-së sipas EASA MED 160

03-3.FMU/PT.001.FRM.001

107 Tension i lartë ose i ulët i gjakut <i>High or low blood pressure</i>			118 Shqetësime psikologjike /psikiatrike të çfarëdo lloji <i>Psychological/psychiatric trouble of any sort</i>			129 Sindrom të çrregullimit të gjumit/apnea <i>Sleep Apnoea</i>			172 Nivel i lartë i kolesterolit <i>High cholesterol level</i>					
108 Gurë në veshka apo gjak në urinë <i>Kidney stone or blood in</i>			119 Alkoholi/droga/ abuzim me substancë <i>Alcohol/drug/substance abuse</i>			130 Sëmundja / dëmtimi muskulo- skeletik <i>Musculoskeletal illness</i>			173 Epilepsi <i>Epilepsy</i>					
109 Diabes, çrregullim hormonal <i>Diabetes, hormone disorder</i>			120 Tentim për vetëvrasje <i>Attempted suicide</i>			131 Refuzim i sigurimit të jetës <i>Refusal of Life insurance</i>			174 Sëmundje mendore <i>Mental illness</i>					
110 Shqetësime të stomakut, mëlcësë apo intestinale <i>Stomach, liver or intestinal trouble</i>			121 Çrregullime të lëvizjes lidhur me ndonjë mjekim <i>Motion sickness requiring medication</i>			132 Refuzimi i Liçencës së fluturimit <i>Refusal of Flying licence</i>			175 Diabet <i>Diabetes</i>					
111 Çrregullime të veshëve/ humbje dëgjimi <i>Deafness, ear disorder</i>			122 Anemia/ malformime qelizore/ çrregullime të tjera të gjakut <i>Anaemia/Sickle cell trait/other blood disorders</i>			133 Refuzimi mjekësor nga ose për shërbimin ushtarak <i>Medical rejection from or for military service</i>			176 Tuberkuloz <i>Tuberculosis</i>					
						134 Dhënie pensioni ose kompensimi për lëndime apo sëmundje <i>Award of pension or compensation for injury or illness</i>			177 Alergji/astma/eczema <i>Allergy/asthma/eczema</i>					
												178 Çrregullime të trashëguara <i>Inherited disorders</i>		
												179 Glaukoma <i>Glaucoma</i>		

(30) Shënime: Nëse është raportuar më parë dhe nuk ka ndryshime që atëherë, deklarojeni.

Remarks: If previously reported and no change since, so state.



AAC/ACAA
FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË
AVIACIONIT CIVIL
APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE



Forma e RSH-së sipas EASA MED 160

03-3.FMU/PT.001.FRM.001

(31) **Deklaratë:** Unë deklaroj se kam shqyrtuar me kujdes deklaratat e bëra më lart dhe nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se ato janë të plota dhe korrekte dhe se unë nuk kam mbajtur të fshehtë asnjë informacion të rëndësishëm ose nuk kam bërë ndonjë deklaratë të rreme. E kuptoj që, nëse kam bërë ndonjë deklaratë të gabuar ose të rreme në lidhje me këtë kërkesë, ose nuk kam lëshuar informacionin mjekësor mbështetës, autoriteti licencues mund të refuzojë të më japë një çertifikatë mjekësore ose mund të tërheqë çdo çertifikatë mjekësore të dhënë, pa paragjykuar/cënua çdo veprim tjetër të zbatueshëm sipas ligjit kombëtar.

I hereby declare that I have carefully considered the statements made above and that to the best of my belief they are complete and correct and that I have not withheld any relevant information or made any misleading statement. I understand, that if I have made any false or misleading statement in connection with this application, or fail to release the supporting medical information, the Licensing Authority may refuse to grant me a medical certificate or may withdraw any medical certificate granted, without prejudice to any other action applicable under national law.

MIRATIM PËR DHËNIE TË INFORMACIONIT MJEKËSOR: Ju lutemi lexoni deklaratën më poshtë në lidhje me shpërndarjen e informacionit. AAC e konsideron të rëndësishme sigurinë e informacionit tuaj personal. Informacioni iu zbulohet vetëm personave që u nënshtrohen një detyrimi konfidencialiteti dhe kur ekzistojnë masa të mjaftueshme sigurie për të mbrojtur të dhënat personale. Nëse nuk jeni dakord për zbulimin /shpërndarjen e informacionit siç përshkruhet më poshtë, mund të kontaktoni nëpërmjet adresës zyrtare të AAC-së.

CONSENT TO RELEASE OF MEDICAL INFORMATION: Please read the statement below in relation to disclosure of information. The ACAA takes the security of your personal information very seriously. Information is only disclosed to persons who are subject to a duty of confidentiality and where there are sufficient security measures in place to protect personal data. If you do not consent to the disclosure of information as described below, you may make representations to ACAA website

Me dorëzimin e këtij aplikimi, unë jap pëlqimin tim për shpërndarjen tek palët të treta të të gjitha informacioneve që unë i kam dhënë AAC-së dhe që kanë të bëjnë me mua. Unë e kuptoj që informacioni që do t'i u zbulohet vetëm palëve të treta nga AAC do të jetë vetëm për qëllime rregullatore. Kjo mund të përfshijë dhënie të informacionit profesionistëve të tjerë mjekësor, punonjësve administrativë dhe/ose punonjësve të IT-së që ndihmojnë AAC-në në realizimin e funksioneve të saj rregullatore, të cilëve iu jepet akses në informacionet personale në kuadër të ushtrimit të detyrave të tyre profesionale.

In submitting this application, I am consenting to the disclosure to third parties of all information which I have provided to the CAA and that relates to me. I understand that information would only be disclosed to third parties by the CAA for regulatory purposes. This may include providing information to other medical professionals. Administrative workers and/or IT workers who are assisting the CAA with its regulatory functions may also be given access to personal information in the course of their professional duties.



03-3.FMU/PT.001.FRM.001

FAQE INSTRUKTUESE PËR PLOTËSIMIN E FORMËS SË APLIKIMIT PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË AVIACIONIT CIVIL

Ky formular aplikimi dhe të gjitha format e raportit bashkëlidhur do të përcillen tek autoriteti licencues. Konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në çdo kohë.

Aplikantët duhet të plotësojnë personalisht të gjitha pyetjet në Formën e Aplikimit. Shkrimi duhet të jetë me gërma të mëdha të shtypit duke përdorur një stilolaps me bojë si dhe të jetë i lexueshëm. Nëse nevojitet më shumë hapësirë për t'u përgjigjur ndonjë pyetjeje, duhet të përdoret një fletë e thjeshtë letrë, që mban emrin dhe nënshkrimin e aplikantit dhe datën e nënshkrimit. Instruksionet e mëposhtme me numra përdoren në të njëjtën temë me të njëjtin numër në Formën e Aplikimit.

The applicant must personally complete in full all questions (boxes) on the Application Form. Writing must be in block capitals using a ball-point pen and be legible. Completion of this form by typing/printing is also acceptable. If more space is required to answer any question, use a plain sheet of paper bearing the information, your signature and the date signed. The following numbered instructions apply to the numbered headings on the application form.

Shënim: Pamundësia për plotësimin e plotë të formularit të aplikimit, ose përdorimi i shkrimit të palexueshëm, mund të rezultojë në mospranim të formularit të aplikimit. Bërja e deklaratave të rreme ose mashtruese ose fshehja e informacionit përkatës në lidhje me këtë kërkesë mund të rezultojë në ndjekjen penale, mohimin e kësaj kërkesë dhe / ose tërheqjen e çdo çertifikate (ave) mjekësore të dhënë. NOTICE: Failure to complete the application form in full or to write legibly will result in non-acceptance of the application form. The making of false or misleading statements or the withholding of relevant information in respect of this application may result in criminal prosecution, denial of this application and/or withdrawal of any medical certificate(s) granted.	
1. SHTETI KU APLIKOHET/STATE APPLIED TO: Deklaroni emrin e vendit ku do të dërgohet ky aplikim. State name of Country this application is to be forwarded to	17. APLIKIMI I FUNDIT MJEKSOR/LAST MEDICAL APPLICATION: Deklaroni (ditën, muajin, vitin) dhe vendin (qytetin, shtetin) State date (day, month, year) and place (Town, Country) Aplikantët fillestar vendosin"ASNJË" Initial applicants state "NONE"
2. KLASA E ÇERTIFIKATËS MJEKËSORE/CLASS OF MEDICAL CERTIFICATE: Shënoni kutinë përkatëse/Tick appropriate box: Klasa 1: Pilot profesional/Class 1: Professional Pilot Klasa 2: Pilot Privat/Class 2: Private Pilot LAPL	18. LIÇENCA E AVIACIONIT E MBAJTUR/ AVIATION LICENCE HELD: Vendosni tipin e liçencës së mbajtur si përgjigje në Pyetjen (14). Vendosni numrin e liçencës dhe shtetin e lëshimit.Nëse s'ka pasur një liçencë të mbajtur, deklarohej "ASNJË" State type of licences held as answered in Question (14). Enter licence number and State of issue for each licence. If no licences are held, state "NONE"
3. MBIEMRI/SURNAME Vendosni mbiemrin State Surname/Family name	19.NDONJË LIMITIM NË LIÇENCË APO ÇERTIFIKATË MJEKËSORE/ ANY LIMITATIONS ON THE LICENCE/MEDICAL CERTIFICATE: Shënoni kutinë përkatëse dhe jepni detajet për ndonjë limitim në liçencën tuaj ose çertifikatën mjekësore, p.sh shikimi, shikimi i ngjyrave , pilot sigurie etj. Tick appropriate box and give details of any limitations on your licences / medical certificates, e.g. vision, colour vision, safety pilot, etc.
4. MBIEMRA TË MËPARSHËM /PREVIOUS SURNAM (S Nëse mbiemri ose emri i familjes suaj ka ndryshuar për ndonjë arsye, vendosni emra/mbiemrat e mëparshëm If your surname or family name has changed for any reason, state previous name(s)	20.MOHIMI OSE REVOKIMI I ÇERTIFIKATËS MJEKËSORE/ MEDICAL CERTIFICATE DENIAL OR REVOCATION: Vendosni "PO" në kuti nëse keni pasur ndonjëherë çertifikatë mjekësore të mohuar ose revokuar edhe nëse vetëm përkohësisht.Nëse "PO" vendosni datën (DD/MM/YYYY) Tick "YES" box if you have ever had a medical certificate denied or revoked even if only temporary. If 'YES', state date (DD/MM/YYYY) and Country where occurred
5.EMRA TË NDËRMJETËM /FORENAMES: Vendosni emrin e parë dhe të mesëm(maksimumi tre) State first and middle names (maximum three)	21.KOHA TOTALE E FLUTURIMIT TË PILOTIT/ PILOT FLIGHT TIME TOTAL: Vendosni numrin total te oreve te fluturimit State total number of hours flown
6.DATA E LINDJES/ DATE OF BIRTH: Specifikoni sipas rendit Dita(DD),Muaji(MM), Viti(YYYY) me numra. Specify in order Day(DD), Month(MM), Year(YYYY) in numerals, e.g. 31-01-1990	22.KOHA E FLUTURIMIT E PILOTIT QË NGA EKZAMINIMI MJEKËSOR I FUNDIT/ PILOT FLIGHT TIME SINCE LAST MEDICAL: Vendosni numrin e orëve të fluturimit që nga ekzaminimi mjekësor i fundit. State number of hours flown since your last medical examination
7. GJINIA/SEX: Shënoni kutinë përkatëse Tick appropriate box	23. AVIONI QË FLUTURONI MOMENTALISHT/AIRCRAFT PRESENTLY FLOWN: Vendosni emrin e avionit që fluturon, p.sh Boeing 737, Cessna 150, etj State name of principal aircraft flown, e.g. Boeing 737, Cessna 150, etc.

	AAC/ACAA FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE TË AVIACIONIT CIVIL APPLICATION FORM FOR AVIATION MEDICAL CERTIFICATE	
--	--	---

Forma e RSH-së sipas EASA MED 160

03-3.FMU/PT.001.FRM.001

8.VENDI I LINDJES/ PLACE OF BIRTH: Vendosni qytetin dhe shtetin e lindjes State Town and Country of birth	24.AKSIDENTE/INCIDENTE ME AVIONIN/ AIRCRAFT ACCIDENT/INCIDENT: Nëse "PO" shëno në kutinë përkatëse Datën(DD.MM.YYYY) dhe vendin e aksidentit/incidentit If "YES" box ticked, state Date (DD/MM/YYYY) and Country of accident/incident
9.KOMBËSIA/ NATIONALITY: Vendosni emrin e shtetit ku jeni qytetar State name of Country of citizenship	25. TIPI QË DO TË FLUTURONI/TYPE OF FLYING INTENDED: Vendosni nëse është linjë ajrore,transport ajror tregtar me pilot të vetëm i cili mban pasagjerë,agrikulturë,etj. State whether airline, charter, single-pilot commercial air transport carrying passengers, agriculture, pleasure, etc.
10.ADRESA/ PERMANENT ADDRESS: Vendosni adresën postare të përhershme dhe shtetin.Shënoni kodin telefonik të zonës ashtu dhe numrin State permanent postal address and country. Enter telephone area code as well as number	26. AKTIVITETI FLUTURUES I MOMENTIT/PRESENT FLYING ACTIVITY: Shënoni kutizën e duhur për të treguar nëse fluturon si pilot i vetëm ose jo. Tick appropriate box to indicate whether you fly as the SOLE pilot or not
11. ADRESA POSTARE/POSTAL ADDRESS: Nëse ndryshon nga adresa e përhershme, shkruajeni adresën e plotë postare aktuale duke përfshirë numrin e telefonit dhe kodin e zonës. Nëse është e njëjtë shkruani "E njëjtë" If different from permanent address, state full current postal address including telephone number and area code. If the same, enter "SAME"	27. A PINI ALKOOL?/DO YOU DRINK ALCOHOL? Shënoni në kutinë përkatëse. Nëse "PO", shënoni sasinë javore të konsumit p.sh 2 litra birrë. Tick applicable box. If "YES", state weekly alcohol consumption, e.g. 2 liters beer
12. APLIKIMI/APPLICATION: Plotësoni kutinë përkatëse Tick appropriate box	28.A PËRDORNI MOMENTALISHT NDOJË MEDIKAMENT? / DO YOU CURRENTLY USE ANY MEDICATION?: Nëse "PO", jepni detaje të plota - emrin, sasinë që merrni dhe kur etj. Përfshini çdo medikament pa recetë mjekësore. If "YES", give full details - name, how much you take and when, etc. Include any non-prescription medication
13.NUMRI I REFERENCËS/ REFERENCE NUMBER: Vendosni numrin e referencës të caktuar për ju nga Autoriteti i Aviacionit Kombëtar. Aplikantët fillestarë të vendosin "ASNJE". State Reference Number allocated to you by your National Aviation Authority. Initial Applicants enter "NONE"	29. A PINI DUHAN?/ DO YOU SMOKE TOBACCO?: Shënoni kutizën e aplikueshme. Duhanpirësit vendosin tipin (cigare, puro, llullë) dhe sasinë(p.sh. 2 cigare në ditë; duhan me llullë – 10gr. Në javë etj.). Tick applicable box. Current smokers state type (cigarettes, cigars, pipe) and amount (e.g. 2 cigars daily, pipe – 1 oz. weekly)
14. TIPI I LICENCËS PËR TË CILËN APLIKOHET OSE (SYNONI TË APLIKONI) : /TYPE OF LICENCE APPLIED FOR (OR INTENDED): Vendosni tipin e licencës për të cilën aplikohet, nga lista e mëposhtme: / State type of licence applied for from the following list: Licencë Transporti për Pilotë për Avionë/ Aeroplane Transport Pilot Licence. Licencë Piloti Tregtare me IR/Commercial Pilot Licence/Instrument Rating Licencë Piloti Tregtare/Commercial Pilot Licence Licencë Private Piloti me IR/Private Pilot Licence/Instrument Rating Pilot Privat/Private Pilot Pilot Student/Student Pilot Dhe nëse me krahë të fiksuar/ të rotulueshëm/ ose të dyja and whether Fixed Wing/ Rotary Wing/ Both	30.HISTORIK I PËRGJITHSHËM MJEKËSOR:/ GENERAL MEDICAL HISTORY: Të gjithë artikujt nën këtë nëntitull nga numri 101 deri në 179 duhet të kenë përgjigjen "PO" ose "JO". JU duhet të shënoni "PO" nëse keni pasur ndonjë gjendje mjekësore në jetën tuaj dhe të përshkruani gjendjen si dhe datën e përafërt në kutinë "30 SHËNIME". Të gjitha pyetjet e bëra janë me rëndësi nga pikëpamja mjekësore edhe pse kjo mund të mos jetë menjëherë e dukshme. Njësitë e numëruara nga 170 deri në 179 kanë të bëjnë me historikun e familjes aktual, ndërsa në njësitë e numëruara nga 150 deri në 151 duhet të përgjigjen vetëm gratë aplikante. Nëse informacioni është raportuar në një formë tjetër aplikimi të mëparshëm dhe nuk ka pasur ndryshime në gjendjen tuaj, ju mund të deklaroni "Raportuar më parë; asnjë ndryshim që atëherë". Megjithatë, ju duhet gjithsesi të shkruani "Po" për gjendjen. Mos raportoni sëmundje të zakonshme të rastësishme të tilla si ftohjet/gripi. All items under this heading from number 101 to 179 inclusive must have the answer "YES" or "NO" ticked. You MUST tick "YES" if you have ever had the condition in your life and describe the condition and approximate date in the "30. REMARKS" box. All questions asked are medically important even though this may not be readily apparent. Items numbered 170 to 179 relate to immediate family history whereas items numbered 150 to 151 must be answered by female applicants only. If information has been reported on a previous application form and there has been no change in your condition, you may state "Previously reported. No change since" However, you must still tick "YES" to the condition. Do not report occasional common illnesses such as colds
15.PUNËSIMI/ OCCUPATION:	
16.PUNEDHËNËSI/ EMPLOYER: Nëse profesioni kryesor është pilot, atëherë vendosni emrin e punëdhënësit,ose nëse është vetë-punësim,deklaro "vetë". If principal occupation is pilot, then state employer's name or if self-employed, state "self"	31. DEKLARIMI DHE PËLQIMI PËR TË MARRË DHE DHËNË INFORMACION: DECLARATION AND CONSENT TO OBTAINING AND RELEASING INFORMATION: Mos nënshkruani ose datoni këto deklarata derisa t'ju tregohet ta bëni këtë nga AME i cili do të veprojë si dëshmitar dhe do të nënshkruajë në përputhje me rrethanat. Do not sign or date these declarations until indicated to do so by the AME who will act as fitness and sign accordingly.



AAC/ACAA
FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE LAPL
APPLICATION FORM FOR A LAPL MEDICAL CERTIFICATE



O3-3.FMU/PT.001.FRM.002

FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE LAPL

APPLICATION FORM FOR A LAPL MEDICAL CERTIFICATE

Plotësoni këtë faqe me gërma të mëdha të shtypit-Referojuni udhëzimeve për plotësimin.

Complete this page fully and in block capitals - Refer to instructions for completion.

MJEKËSORE NË KONFIDENCË/MEDICAL IN CONFIDENCE

(1) Shteti lëshues i liçencës: <i>State of licence issue</i>		(2) Çertifikata mjekësore për të cilën aplikohet: <i>Medical certificate applied for</i> LAPL	
(3) Mbiemri <i>Surname:</i>		(4) Mbiemra të mëparshëm <i>Previous surname(s)</i>	(12) Aplikim/Application: Fillestar/Initial ☐ Rivalidim/Rinovim Revalidation/Renewal ☐
(5) Emri (at) <i>Forename(s)</i>	(6) Dita e lindjes (dd/mm/vvvv) <i>Date of birth(dd/mm/yyyy):</i>	(7) Gjinia /Sex: Mashkull/Male ☐ Femër/Female ☐	(13) Numri i referencës <i>Reference number:</i>
(8) Vendi dhe shteti i lindjes <i>Place and country of birth:</i>		(9) Kombësia <i>Nationality:</i>	(14) Tipi i Liçencës së kërkuar <i>Type of licence applied for:</i>
(10) Adresa e përhershme/ <i>Permanent Address:</i> Shteti/Country: Nr. Telefoni/Telephone No: Cel./Mobile No.: E-mail:		(11) Adresa postare (nëse është e ndryshme) <i>Postal address (if different):</i> Shteti/Country: Nr.Telefoni/Telephone No:	(15) Punësimi(kryesor)/Occupation (principal): (16) Punëdhënësi/Employer: (17) Ekzaminimi i fundit Data: <i>Last medical examination: Date:</i> Vëndi/Place:
(18) Liçenca e mbajtur(tipi): <i>Licence(s) held (type):</i> Nr.,i Liçencës/Licence Number: Shteti i lëshimit/ <i>State of issue:</i>		(19) Çdo limitim në Liçencë/Çertifikatë mjekësore të mbajtur Po ☐ Jo ☐ <i>Any limitations on licence(s)/medical certificate held</i> Yes ☐ No ☐ Detaje: <i>Details:</i>	
(20) A ju është mohuar, pezulluar, apo anuluar ndonjëherë çertifikata mjekësore nga ndonjë autoritet liçencues? <i>Have you ever had a medical certificate denied, suspended or revoked by any licensing authority?</i> Jo/No ☐ Po/Yes ☐ Data/Date: Shteti/Country: Detaje/Details:		(21) Totali i kohës së fluturimit: <i>Flight time total:</i>	(22) Koha e fluturimit që nga mjekësori i fundit: <i>Flight time since last medical:</i>
(24) Ndonjë aksident ose incident i raportuar që nga mjekësori i fundit? <i>Any aviation accident or reported incident since last medical examination?</i> Jo/No ☐ Po/Yes ☐ Data/Date: Vendi/Place: Detaje/Details:		(23) Tipi/Klasa e avionit që fluturohet aktualisht: <i>Aircraft class/type(s) presently flown</i>	
(27) A pini alkool? <i>Do you drink alcohol?</i> ☐ Po/Yes ☐ Jo/No, sasia/amount		(25) Tipi i synuar i fluturimit: <i>Type of flying intended:</i>	
(29) A pini duhan? / <i>Do you smoke tobacco?</i> ☐ Jo, kurrë/No,never ☐ Jo, data kur e keni lënë/ No, date stopped: ☐ Po, vendosni tipin dhe sasinë/Yes, state type and amount:		(26) Aktiviteti aktual i fluturimit/Present flying activity: Me një pilot/Single pilot ☐ Multi – pilot/Multi pilot ☐	
		(28) A përdorni ndonjë ilaç, aktualisht? <i>Do you currently use any medication?</i> Jo/No ☐ Po/Yes ☐ Vendorsni dozën e mjekimit, datën e fillimit dhe pse: <i>State medication, dose, date started and why:</i>	

Historik i përgjithshëm dhe mjekësor: A keni apo keni pasur ndonjëherë ndonjë nga të renditurat më poshtë? (Ju lutem shënoni). Nëse po, jepni detaje në seksionin e shënimeve (30).
General and medical history: Do you have, or have you ever had, any of the following? (Please tick). If yes, give details in remarks section (30).

	Po/Yes	Jo/No		Po/Yes	Jo/No		Po/Yes	Jo/No	Historiku Familjar/Family history of:	Po/Yes	Jo/No
101 Shqetësime të syve/operation të syve <i>Eye trouble/eye operation</i>			112 Çrregullime të hundës,fytit, të të folurit <i>Nose, throat or speech disorder</i>			123 Malaria/ose sëmundje tjetër tropikale <i>Malaria or other tropical disease</i>			170 Sëmundje të zemrës <i>Heart disease</i>		
102 Syzet dhe / ose lentet e kontaktit të vendosura ndonjëherë <i>Spectacles and/or contact lenses ever worn</i>			113 Përplasje apo dëmtim në kokë. <i>Head injury or concussion</i>			124 HIV test positive <i>A positive HIV test</i>			171 Presion i lartë i gjakut <i>High blood pressure</i>		
			114 Dhimbje koke të forta/të shpeshta <i>Frequent or severe headaches</i>			125 Sëmundje seksualisht të transmetuara <i>Sexually transmitted disease</i>			172 Nivel i lartë i kolesterolit <i>High cholesterol level</i>		
103 Ndryshimi i recetave të syzeve/ lenteve të kontaktit / që nga ekzaminimi i fundit mjekësor.			115 Marrje mendësh apo të fikët <i>Dizziness or fainting spells</i>			126 Sindrom të çrregullimit të gjumit/apnea <i>Sleep disorder/apnoea syndrome</i>			173 Epilepsi <i>Epilepsy</i>		



AAC/ACAA
FORMË APLIKIMI PËR ÇERTIFIKATË MJEKËSORE LAPL
APPLICATION FORM FOR A LAPL MEDICAL CERTIFICATE



O3-3.FMU/PT.001.FRM.002

Spectacle/contact lens prescriptions change since last medical exam.		116 Humbje ndjenjash për çfarëdo arsye Unconsciousness for any reason		127 Sëmundja / dëmtimi muskulo-skeletik Musculoskeletal illness/impairment		174 Sëmundje mendore Mental illness	
104 Ethet Hey, alergji të tjera Hay fever, other allergy		117 Çrregullime neurologjike; ictus, epilepsi, konvulsione, paralizë, etj. Neurological disorders; stroke, epilepsy, seizure, paralysis, etc		128 Çdo sëmundje ose lëndim tjetër Any other illness or injury		175 Diabet Diabetes	
105 Astma, sëmundje të mushkërive Asthma, lung disease				129 Shtrim në spital Admission to hospital		176 Tuberkuloz Tuberculosis	
106 Probleme të zemrës ose vaskulare Heart or vascular trouble		118 Shqetësime psikologjike /psikiatrike të çfarëdo lloji Psychological/psychiatric trouble of any sort		128 130 Vizita në mjekë të përgjithshëm që nga mjekimi i fundit Visit to medical practitioner since last medical examination		177 Allergji/astma/eczema Allergy/asthma/eczema	
107 Tension i lartë ose i ulët i gjakut High or low blood pressure						178 Çrregullime të trashëguara Inherited disorders	
108 Gurë në veshka apo gjak në urinë Kidney stone or blood in urine		119 Alkool/droga/ abuzim me substanca Alcohol/drug/substance abuse		129 131 Refuzim i sigurimit të jetës Refusal of life insurance		179 Glaukoma Glaucoma	
109 Diabet, çrregullim hormonal Diabetes, hormone disorder		120 Tentim për vetëvrasje. Attempted suicide		130 132 Refuzim i Liçencës së fluturimit Refusal of flying licence		Vetëm Femrat/ Females only:	
110 Shqetësime të stomakut, mëlçsë apo intestinale Stomach, liver or intestinal trouble		121 Çrregullime të lëvizjes lidhur me ndonjë mjekim Motion sickness requiring medication		132 133 Refuzim mjekësor nga ose për shërbimin ushtarak Medical rejection from or for military service		150 Probleme gjinekologjike, menstruale Gynaecological, menstrual problems	
111 Çrregullime të veshëve/ humbje dëgjimi Deafness, ear disorder		122 Anemia/malformime qelizore /çrregullime të tjera të gjakut Anaemia/sickle cell trait/other blood disorders		134 Dhënie pensioni ose kompensimi për lëndime apo sëmundje Award of pension or compensation for injury or illness		151 A jeni shtatzënë? Are you pregnant?	

(30) **Shënime:** Nëse është raportuar më parë dhe nuk ka ndryshime që atëherë, deklaroni.

(30) **Remarks:** If previously reported and no change since, so state.

(31) Deklaratë: Unë deklaroj se kam shqyrtuar me kujdes deklaratat e bëra më lart dhe nën përgjegjësinë time të plotë, deklaroj se ato janë të plota dhe korrekte dhe se unë nuk kam mbajtur të fshehtë asnjë informacion të rëndësishëm ose nuk kam bërë ndonjë deklaratë të rreme. E kuptoj që, nëse kam bërë ndonjë deklaratë të gabuar ose të rreme në lidhje me këtë kërkesë, ose nuk kam lëshuar informacionin mjekësor mbështetës, autoriteti liçencues mund të refuzojë të më japë një certifikatë mjekësore ose mund të tërheqë çdo certifikatë mjekësore të dhënë, pa paragjykuar/cënuar çdo veprim tjetër të zbatueshëm sipas ligjit kombëtar.

PËLQIMI PËR DHËNIEN E INFORMACIONIT MJEKËSOR: Ju lutemi lexoni deklaratën më poshtë në lidhje me shpërndarjen e informacionit. AAC konsideron me shumë seriozitet sigurinë e informacionit tuaj personal. Informacioni iu zbulohet vetëm personave që u nënshtrohen një detyrimi konfidencialiteti dhe kur ekzistojnë masa të mjaftueshme sigurie për të mbrojtur të dhënat personale. Nëse nuk jeni dakord për zbulimin /shpërndarjen e informacionit siç përshkruhet më poshtë, mund të bëni deklaratë në info@acaa.gov.al

